



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 191/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.04.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Medfau” SHPK. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-65892-07-18-2020, me objekt “*F.V Pajisje mjekësore –CT Scanner*”, me fond limit 144.112.500 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 23.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.”

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK. në procedurën e mësipërme të prokurimit.”

Ankimues:

“Medfau” SHPK.
Rruga “4 Dëshmorët”, Nr.195, Tiranë

“BNT Electronics” SHPK
Bulevardi “Zhan D’ark”, Ndërtesa 32, Hyrja 16, Kati II, Ap.1,
Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Rruga e Kavajës, nr. 1001, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 20.07.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-65892-07-18-2020, me objekt “F.V Pajisje mjekësore –CT Scanner”, me fond limit 144.112.500 lekë (pa

TVSH), zhvilluar në datën 23.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

II.2. Në datën 23.09.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 13.10.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Medfau” SHPK.	79.790.000 lekë, skualifikuar
2. “Health & Light” SHPK.	80.750.000 lekë, skualifikuar
3. “BNT Electronics” SHPK.	85.961.928 lekë, skualifikuar
4. “Montal” SHPK.	99.740.000 lekë, kualifikuar
5. “Albaphoto” SHPK.	122.000.000 lekë, skualifikuar
6. “Biometric Albania” SHPK.	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
7. “MSE” SHPK.	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
8. “Euromed” SHPK.	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

II.4. Në datën 13.10.2020 operatori ekonomik “Medfau” SHPK. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, për arsyet si më poshtë vijon:

[...]

Dokumentacioni i paraqitur për plotësimin e kriterëve të veçanta për kualifikim (KVK) rezulton jo i plotë dhe nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në DST, konkretisht:

Pika 2.3, Kapaciteti teknik:

Për sa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

Në Kreun II, seksioni I të dokumenteve të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” ku përcaktohet se: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”, konkretisht Kriteret e Veçanta të Kualifikimit,

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shënohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertës dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe në pjeset që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST).

1. OE nuk ka paraqitur katalogun e Injektorit të kontrastit për verifikimin e specifikimeve të kërkuara më poshtë:

Injektor kontrasti me presion të lartë për CT

Me komandim në distancë dhe në injektor

Me nje koke, me shiringe kontrasti me kapacitet: 200 mL

Fluksi: 0.1- 10 ml/sec

Hapi: ≤ 0.1 mL /sec

Nga vleresimi i ofertës teknike rezulton se oferta e ofertuar nuk plotëson specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet Standarde të tenderit

Për pajisjen Skaner 64 slice

1. Në Dst është kerkuar: Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlera ekuivalente, me permiresim nga softueri), ≥ 30 MHU

Në ofertën teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlera ekuivalente, me permiresim nga softueri), 17.5 MHU

2. Në Dst është kerkuar: Rezolucioni Maksimal i Kontrastit (MTF) ≥ 21 lp/cm ne 2% ose ≥ 18 lp/cm ne 4%

Në ofertën teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Rezolucioni Maksimal i Kontrastit (MTF) 15.1 lp/cm ($\pm 10\%$) @ 2% MTF

3. Në Dst është kerkuar: Minimizimi i dozës, krahasuar me teknika standarde, deri ne jo me pak se $\geq 80\%$

Në ofertën teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Minimizimi i dozës, krahasuar me teknika standarde 60%

Për pajisjen Skaner 16 slice

4. Në Dst është kerkuar: Fuqia, kw (vlera nominale, pa permiresim nga softueri) ≥ 50 kw

Në ofertën teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Fuqia, kw (vlera nominale, pa permiresim nga softueri) 32 kw

5. Në Dst është kerkuar: Diapazoni i gjerësisë së prerjes: nga ≤ 0.65 deri ≥ 5 mm

Në ofertën teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Diapazoni i gjerësisë së prerjes, 0.7 mm

6. Në Dst është kerkuar: Koha minimale e një rrotullimi 360°, ≤ 0.5 sekonda

Në ofertën teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Koha minimale e një rrotullimi 360°, 0.8 sekonda

7. Në Dst është kerkuar: Koha maksimale e një rrotullimi 360°, 0.2 sekonda

Në ofertën teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Koha maksimale e një rrotullimi 360°, 1.5 sekonda

8. Në Dst është kerkuar: Numri i opsioneve për zgjedhjen e kohës për një rrotullim 360°, ≥ 6 .

Në ofertën teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Numri i opsioneve për zgjedhjen e kohës për një rrotullim 360°, 3

9. Në Dst është kerkuar: Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlera nominale, pa permiresim nga softueri), ≥ 5 MHU

Në ofertën teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlera nominale, pa permiresim nga softueri), 3.5 MHU

10. Në Dst është kerkuar: Largimi i nxehtësisë së Anodes (ftohja) ≥ 800 kHU/min

Në ofertën teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Largimi i nxehtësisë së Anodes (ftohja) 567kHU/min

Nuk jepen të dhëna për plotësimin e specifikimeve të mëposhtme:

Minimizimi i zhurmës, krahasuar me teknika standarde i cili duhet të jete $\geq 90\%$

Maksimumi i mA për pikën e vogël fokale i cili duhet të jete ≥ 200 mA

Koha maksimale e ekspozimit të vazhduar në 120 kV & 200mA e cila kerkohet të jete ≥ 80 sec

Modeli i ofruar ka edhe disa devijime të vogla:

11. Në Dst eshte kerkuar: Monitor i integruar ne gantry per paraqitjen e te dhenave te pacientit dhe kontroll te pozicionimit me prekjes ose butona monitor

Në ofertën teknike të këtij OE, ky monitor nuk eshte ofruar i integruar

12. Në Dst eshte kerkuar: Rezolucioni hapësinor, ne shpejtesine maksimale te rrotullimit (FOV=50cm) ≤ 0.30 mm

Në ofertën teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Rezolucioni hapësinor, ne shpejtesine maksimale te rrotullimit (FOV=50cm) 0.33 mm

13. Në Dst eshte kerkuar: Diapazoni i Levizjes vertikale, cm nga ≤ 45 deri ne ≥ 90 cm

Në ofertën teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Diapazoni i Levizjes vertikale, cm 46-88.5 cm

14. Në Dst eshte kerkuar: Diapazoni ne dispozicion, kV: nga ≤ 90 deri ne ≥ 135 kV

Në ofertën teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Diapazoni ne dispozicion, kV 80-130 kV

15. Në Dst është kerkuar: Gjeresia e plote e detektorit (mbulimi) ne drejtimin gjatesor (aksi-z), mm ≥ 40 mm.

Në ofertën teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Gjeresia e plote e detektorit (mbulimi) ne drejtimin gjatesor (aksiz), 38.4 mm.

II.4.1. Në datën 20.10.2020 operatori ekonomik “Medfau” SHPK. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike. Konkretisht, operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij pranë autoritetit kontraktor pretendon si më poshtë: [...]

Ne radhe te pare deshirojme tju informojme qe nje gje te tille te gjitha kompanite pjesemarrrese ne kete procedure te hapur prokurimi e kishin shprehur qe ne momentin e publikimit te specifikimeve teknike (qe do te kishte ne menyre absolute favorizim te kompanise prodhuese GE - Montal si perfaqesi e tyre ne Shqiperi). Kete shqetesim ne e kemi shprehur edhe ne ankesen qe kompania Medfau SHPK ka bere prane autoritetit kontraktor me numer 3403 date 27.07.2020 (bashkengjitur ankesa jone) dhe ne pergjigjen e ardhur nga Autoriteti Kontraktor me numer 3403/18 date 30.07.2020. Edhe ne ankimimin qe kompania BNT Electronics dhe Health & Light kane bere prane Komisionit te Prokurimit Publik duket qarte qe specifikimet teknike te publikuara jane per te favorizuar nje kompani prodhuese GE, madje ne ankesën drejtuar ketij komisioni jane shprehur edhe modelet te cilat jane paracaktuar te fitojne, konkretisht modelet e CT te kompanise prodhuese GE - REVOLUTION EVO DHE OPTIMA 540. Keto modele shfaqen vazhdimisht gjate kundërshtimit te specifikimeve teknike te operatoreve te interesuar BNT Electronics dhe Helath & Light ne kete ankimim. (bashkengjitur nje kopje e vendimit numer 349/2020 e dates 28.08.2020 e marre nga faqja zyrtare e KPP). Ky vendim eshte me numer 349/2020 dhe eshte mbajtur me date 28.08.2020 pra perpara hapjes se" PROCEDURES SE HAPUR" organizuar nga Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale.

Sipas ketyre fakteve duket qarte qe kemi te bejme me nje tender ku fituesi eshte i paracaktuar sepse pavarësisht vendimit te KPP ndryshimet e kryera perseri favorizojne dukshem kompanine prodhuese GE dhe pengojne nje pjesemarrje te hapur sic edhe procedura pretendoni qe eshte.

Se dyti oferta jone si oferta ekonomike me e ulet duhet te shpallet fituese ne menyre automatike dhe pretendimet nga ana juaj per devijime ne specifikime teknike jane vetem pjese e asaj qe ju keni planifikuar qe ne publikimin e kesaj procedure te hapur prokurimi. Skualifikimi I ofertes tone

ekonomike dhe kualifikimi i nje operatori i cili ka nje vlere relativisht nje vlere 20.000.000 leke qe do te thote qe oferta jone eshte rreth 25 % me e ulet se oferta qe ju keni kualifikuar.

Per sa i perket pretendimeve tuaja teknike po ju sqarojme qe dokumentacionin per injektorin kompania jone ka paraqitur nje deklarate per permbushjen e specifikimeve teknike dhe gjithashtu ka paraqitur edhe nje deklarate ku deklararon modelin dhe kompanine prodhuese. Edhe katalogu eshte paraqitur ne faqen e APP dhe kompania Medfau SHPK ka bere nje kerkese per informacion per problemin teknik te ndodhur, qe ky katalog nuk eshte pasqyruar ne dokumentacionin e dorezuar. (bashkengjitur edhe nje kopje e katalogut i cili eshte noterizuar me date 16.09.2020). Gjithsesi objekt i procedures se prokurimit eshte CT Scanner, e cila ka edhe vleren financiare me te madhe ne kete prokurim te hapur dhe nuk mendojme qe shiringa elektrike mund te kete nje vlere per skualifikimin e ofertes tone ekonomike me te mire.

Per sa i perket pretendimit tuaj per mospermbushjen e specifikimeve teknike te CT 64 slice duam tju informojme qe CT Siemens qe ne kemi ofruar ka nje kohe me te shkurter ekzaminimi per shkak te teknologjise qe Siemens ofron prandaj dhe tubi nuk ka nevojte per ftohje me te madhe. Eshte shume e rendesishme qe te percaktohet se sa ekzaminime kerkohen te behen nga ky CT ne mase kohore.

Ky produkt CT Siemens punon me vlere edhe te pareduktuara me te uleta se produktet e tjera te kompetitoreve. Ju mundet te krahasoni edhe rrymat e llambave midis produktit Siemens te ofruar dhe produktit te kompanise qe ju keni paracaktuar fitues.

Per sa i perket pretendimeve per mospermbushjene specifikimeve teknike te CT 16 Slice duam tju informojme qe ne kemi ofruar nje CT me 64 slice. Kjo krijon mundesine qe CT e ofruar nga ne eshte shume me e shpejte nga sa kerkuar dhe llamba rrezaton me pak per te njejtin ekzaminim. Kjo sjell me pak rrezatim per pacientin. Llamba ngarkohet me pak, ngrohet me pak dhe normalisht nuk ka nevojte per ftohje te madhe. Nese CT me 16 slice ben 10 paciente ne njesi kohe , CT Siemens qe ne kemi ofruar kryen 4 here me shume paciente ne te njejten njesi kohe.

Duke qene se ne kemi ofruar nje CT i cili eshte 64 slice nga 16 slice qe ju kerkoni dhe eshte 32 detectors rows nga 24 detector rows qe kerkohen nuk mundemi te bejme krahasime ne specifikime teknike duke qene se ne kemi ofruar nje CT qe ka benefite shume me te mira duke ofruar me teper detaje ne ekzaminim dhe detektim per nje ekzaminim me te mire per pacientin dhe me pak rrezatim. Keto CT qe Siemens ofron kane doze me te ulet per pacientin duke perdorur nje teknologji te avancuar te viteve te fundit nga kompania Siemens. Karakteristikat e kesaj teknologjie jane te ndryshme nga kompanite konkurente dhe si e tille edhe nje krahasim eshte veshtire te behet, por duhet pasur parasysh perfitimet per pacientin jane te medha ne keto CT qe ne kemi ofruar me nje teknologji te viteve te fundit dhe nje kualitet te larte sherbimi ne sherbim te pacienteve.

Per sa me siper ne kerkojme:

- Ndryshimin e vendimit te Komisionit te vleresimit te Ofertave dhe kualifikimin si oferte te vlefshme dhe fituese te ofertes se kompanise Medfau SHPK (duke qene se eshte oferta me e ulet financiare).

II.4.2. Në datën 22.10.2020, me shkresën nr. 3403/40 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar ankesën e tij në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit. Operatori ekonomik ankimues pretendon se ka marrë dëgjimin në lidhje me shkresën e mësipërme në datë 26.10.2020. Konkretisht autoriteti kontraktor ka argumentuar:

III. Komisioni i ngarkuar per shqyrtimin e ankesave dhe dhenien e vendimit pas shqyrtimit te tyre dhe dokumentacionit qe disponon ne lidhje me proceduren e mesiperme te prokurimit,

Arsyeton:

III.1. Per dokumentacionin per injektorin:

Komisioni pasi beri verifikimet e nevojshme, duke garantuar parimin e barazise, konkurrencës dhe mosdiskriminimit te percaktuar ne ligjin e prokurimeve, sqaron se OE nuk ka paraqitur katalogun e Injektorit te kontrastit per verifikimin e specifikimeve te kerkuara me poshte:

- Injektor kontrasti me presion te larte per CT
- Me komandim ne distance dhe ne injector
- Me nje koke, me shiringe kontrasti me kapacitet: 200 ml
- Fluksi: 0.1- 10 ml/sec
- Hapi: ≤ 0.1 ml /sec

OE ankimes e pranon kete fakt por e justifikon me arsye objektive kete fakt, sic mosfeksionimi SPE te APP.

Per aq kohe sa OE ankimes nuk ka depozituar dokumentacionin e kerkuar, nuk ploteson kriteret e vecanta te kualifikimit.

Sa me siper ky pretendim nuk qendron.

III.2 Per pajisjen Skaner CT 64 Slice te kerkuar:

Komisioni pasi beri verifikimet e nevojshme, duke garantuar parimin e barazise, konkurrencës dhe mosdiskriminimit te percaktuar ne ligjin e prokurimeve sqaron se nga verifikimi i ofertes teknike rezulton se oferta e ofertuar nuk ploteson specifikimet teknike te percaktuara ne Dokumentet Standarde te tenderit per pajisjen Skaner 64 slice si me poshte:

1. Ne Dst eshte kerkuar: Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlera ekuivalente, me permiresim nga softueri), ≥ 30 MHU

Ne oferten teknike te ketij OE, ky specifikim eshte ofruar: Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlera ekuivalente, me permiresim nga softueri), 17.5 MHU

2. Ne Dst eshte kerkuar: Rezolucioni Maksimal i Kontrastit (MTF) ≥ 21 lp/cm ne 2% ose ≥ 18 lp/cm ne 4%

Ne oferten teknike te ketij OE, ky specifikim eshte ofruar: Rezolucioni Maksimal I Kontrastit (MTF) 15.1 lp/cm (± 10 %) @2% MTF

3. Ne Dst eshte kerkuar: Minimizimi i dozes, krahasuar me teknika standarte, deri ne jo me pak se ≥ 80 %

Ne oferten teknike te ketij OE, ky specifikim eshte ofruar: Minimizimi i dozes, krahasuar me teknika standarde 60%

Vete OE e pranon kete fakt dhe mundohet ta argumetoj mosplotesimin e ketyre specifikimeve. Sa me siper ky pretendim nuk qendron.

III 3. Per pajisjen Skaner CT 16 Slice te kerkuar:

Komisioni pasi beri verifikimet e nevojshme, duke garantuar parimin e barazise, konkurrencës dhe mosdiskriminimit te percaktuar ne ligjin e prokurimeve sqaron, se Per pajisjen Skaner 16 slice OE ankimes nuk ploteson Specifikimet teknike si me poshte vijon (fakt i pranuar edhe ne ankesa nga ky OE):

1. Ne Dst eshte kerkuar: Fuqia, kE (vlera nominale, pa permiresim nga softueri) ≥ 50 kE

Ne oferten teknike te ketij OE, ky specifikim eshte ofruar: Fuqia, kE (vlera nominale, pa permiresim nga softueri) 32 kE

2. Ne Dst eshte kerkuar: Diapazon i gjerësisë së prerjes: nga ≤ 0.65 deri ≥ 5 mm
Ne oferten teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Diapazon i gjerësisë së prerjes, 0.7mm
 3. Ne Dst eshte kerkuar: Koha minimale e një rrotullimi 360°, ≤ 0.5 sekonda
Ne oferten teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Koha minimale e një rrotullimi 360°, 0.8 sekonda
 4. Ne Dst eshte kerkuar: Koha maksimale e një rrotullimi 360°, 0.2 sekonda
Ne oferten teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Koha maksimale e një rrotullimi 360°, 1.5 sekonda
 5. Ne Dst eshte kerkuar: Numri i opsioneve për zgjedhjen e kohës për një rrotullim 360°, ≥ 6 .
Ne oferten teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Numri i opsioneve për zgjedhjen e kohës për një rrotullim 360°, 3
 6. Ne Dst eshte kerkuar: Kapaciteti ngrohës i Anodes (vlera nominale, pa përmirësim nga softueri), ≥ 5 MHU
Ne oferten teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Kapaciteti ngrohës i Anodes (vlera nominale, pa përmirësim nga softueri), 3.5 MHU
 7. Ne Dst eshte kerkuar: Largimi i nxehtësisë së Anodes (ftohja) ≥ 800 kHU/min
Ne oferten teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Largimi i nxehtësisë së Anodes (ftohja) 567kHU/min
- Nuk jepen të dhëna për plotësimin e specifikimeve të mëposhtme:

Minimizimi i zhurmes, krahasuar me teknika standarde i cili duhet të jetë $\geq 90\%$

Maksimumi i mA për pikën e vogël fokale i cili duhet të jetë ≥ 200 mA

Koha maksimale e ekspozimit të vazhduar në 120 kV & 200mA e cila kërkohej të jetë ≥ 80 sec

Sa më sipër ky pretendim nuk qëndron.

VENDOS:

Sa më lart, Komisioni i ngarkuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor për shqyrtimin e ankesës dhe dhenien e vendimit ka vendosur të mos/pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Medfau" SHPK për procedurën e prokurimit "F".V Pajisje mjekësore -CT Scanner". Fondi limit 144,112,500 (njëqind e dyzet e katër milion e një qind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind) Leke pa TVSH. REF-67482-07-31-2020

II.4.3. Në datën 02.11.2020 operatori ekonomik "Medfau" SHPK. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke pretenduar si më poshtë:

[...]

Ne rradhë të parë dëshirojmë tju informojmë, që një gjë të tillë të gjitha kompanitë pjesëmarrëse në këtë procedurë të hapur prokurimi e kishin shprehur që në momentin e publikimit të specifikimeve teknike. (që do të kishte në mënyrë absolute favorizim të kompanisë prodhuese GE - Montal si përfaqësi e tyre në Shqipëri). Këtë shqetësim në e kemi shprehur edhe në ankesën që kompania Medfau SHPK ka bërë pranë autoritetit kontraktor me numër 3403 date 27.07.2020 (bashkëngjitur ankesa jone) dhe në përgjigjen e ardhur nga Autoriteti Kontraktor me numër 3403/18 date 30.07.2020. Por edhe në ankimin që kompania BNT Electronics dhe Health & Light kanë bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duket qartë që specifikimet teknike të publikuara janë për të favorizuar një kompani prodhuese GE, madje në ankesën drejtuar këtij komisioni janë shprehur edhe modelet të cilat janë paracaktuar të fitojnë, konkretisht modelet e CT të kompanisë prodhuese GE - REVOLUTION EVO DHE OPTIMA 540. Këto modele shfaqen

vazhdimisht gjate kundershimit te specifikimeve teknike te operatoreve te interesuar BNT Electronics dhe Helath&light ne kete ankimim. (vendimi numer 349/2020 e dates 28.08.2020 e publikuar ne faqen zyrtare te KPP). Ky vendim eshte me numer 349/2020 dhe eshte mbajtur me date 28.08.2020 pra perpara hapjes se "PROCEDURES SE HAPUR" organizuar nga Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale.

Sipas ketyre fakteve duket qarte qe kemi te bejme me nje tender ku fituesi eshte i paracaktuar sepse pavaresisht vendimit te KPP ndryshimet e kryera perseri favorizojne dukshem kompanine prodhuese GE dhe pengojne nje pjesemarrje te hapur sic edhe procedura pretendoni qe eshte.

Se dyti oferta jone si oferta ekonomike me e ulet duhet te shpallet fituese ne menyre automatike dhe pretendimet nga ana juaj per devijime ne specifikime teknike jane vetem pjese e asaj qe ju keni planifikuar qe ne publikimin e kesaj procedure te hapur prokurimi. Skualifikimi i ofertes tone ekonomike dhe kualifikimi i nje operatori i cili ka nje vlere relativisht nje vlere 20.000.000 leke pa TVSH, qe do te thote qe oferta jone eshte rreth 25 % me e ulet se oferta qe ju keni kualifikuar.

Per sa i perket pretendimeve tuaj teknike po ju sqarojmë, qe dokumentacionin per injektorin kompania jone ka paraqitur nje deklarate per permbushjen e specifikimeve teknike dhe gjithashtu ka paraqitur edhe nje deklarate ku deklarom modelin dhe kompanine prodhuese. (bashkengjitur ju lutem gjeni deklaratat perkatesete paraqitura tek AK). Edhe katalogu eshte paraqitur ne faqen e APP dhe kompania Medfau SHPK ka bere nje kerkese per informacion per problemin teknik te ndodhur, qe ky katalog nuk eshte pasqyruar ne dokumentacionin e dorezuar. Gjithsesi objekt i procedure se prokurimit eshte Furnizim Vendorsje CT Scanner, e cila ka edhe vleren financiare me te madhe ne kete prokurim te hapur dhe nuk mendojme qe shiringa elektrike mund te kete nje vlere per skualifikimin e ofertes tone ekonomike me te mire. Skualifikimi vetem per kete arsye eshte nje diskriminim i paster ne kete procedurete paracaktuar, e shprehur kjo edhe me faktet e mesiperme.

Persa i perket pretendimit tuaj per mospermbushjen e specifikimeve teknike te CT 64 slice nuk qendrojne per arsye sepse duam tju informojme qe CT Siemens qe ne kemi ofruar ka nje kohe me te shkurter ekzaminimi per shkak te teknologjise qe Siemens ofron prandaj dhe tubi nuk ka nevoje per ftohje me te madhe. Eshte shume e rendesishme qe te percaktohet se sa ekzaminime kerkohen te behen nga ky CT ne mase kohore.

Ky produkt CT Siemens punon me vlere edhe te pareduktuar me te uleta se produktet e tjera te kompetitoreve. Ju mundet te krahasoni edhe rrymat e llambave midis produktit Siemens te ofruar dhe produktit te kompanise qe ju keni paracaktuar fitues.

Per sa i perket pretendimeve per mospermbushjen e specifikimeve teknike te CT 16 Slice duam tju informojme qe ne kemi ofruar nje CT me 64 slice. Kjo krijon mundesine qe CT e ofruar nga ne eshte per ftohje te madhe. Nese CT me 16 slice ben 10 paciente ne njesi kohe, CT Siemens qe ne kemi ofruar kryen 4 here me shume paciente ne te nejtën njesi kohe.

Duke qene se ne kemi ofruar nje CT i cili eshte 64 slice nga 16 slice qe ju kerkoni dhe eshte 32 detectors rows nga 24 detector rows qe kerkohen nuk mundemi te bejme krahasime ne specifikime teknike duke qene se ne kemi ofruar nje CT qe ka benefite shume me te mira duke ofruar me teper detaje ne ekzaminim dhe detektim per nje ekzaminim me te mire per pacientin dhe me pak rrezatim per pacientin. Duke vleresuar si te pavlefshme oferten e kompanise Medfau SHPK duam tju komunikojme qe AK ben nje gabim te madh ne te cilin pacientit i mohohet nje ekzaminim me nje rrezatim shume me te vogel dhe per nje diagnostifikim sa me te sakte krahasuar me kompanine GE qe AK ka paracaktuar si fitues ne kete procedure te hapur.

Keto CT qe Siemens ofron kane doze me te ulet per pacientin duke perdorur nje teknologji te avancuar te viteve te fundit nga kompania Siemens. Karakteristikat e kesaj teknologjie jane te ndryshme nga kompanite konkurrenente dhe si e tille edhe nje krahasim eshte veshtire te behet, por duhet pasur parasysh perfitimet per pacientin jane te medha ne keto CT qe ne kemi ofruar me nje teknologji te viteve te fundit dhe nje kualitet te larte sherbimi ne sherbim te pacienteve.

Me date 20.10.2020 kemi drejtuar nje ankese ne Ministrine e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale me numer 3403/34 date 20.10.2020 ku kemi parashtruar shqetesimin tone per kete procedure ku fituesi eshte qartesisht i paracaktuar, por ankesa jone sipas AK pretendimet nuk qendrojne dhe si rrjedhoje nuk ka pranuar ankesen tone dhe nuk ka ndryshuar vendimin e saj duke vleresuar si te refuzuar oferten tone dhe kualifikuar si te vlefshme oferten e paracaktuar te operatorit ekonomik Montal.

Ne kerkojme nga Komisioni i Prokurimit Publik qe te beje vleresimin e specifikimeve teknike me ane te nje specialisti Radiolog, sepse mendojme qe ne Ministrine e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale ka kryer nje vleresim te njeanshem duke favorizuar kompanine GE dhe duke hedhur poshte te gjitha argumentimet tona teknike. Deshirojme tju rikujtojme qe pajisja qe ne kemi ofruar sic e kemi shprehur edhe me lart eshte nje pajisje qe i tejkalon specifikimet teknike dhe sipas LPP Neni 23 Specifikimet teknike fjala "Ekuivalent" favorizon bindshem oferten tone teknike.

E bejme kete ankese prane Komisionit te Prokurimit Publik duke marre shkas edhe nga nje procedure e ngjashme qe kompania jone ka pasur me Autoritetin Kontraktor Spitali Universitar I Traumes, ku kompania jone u kualifikua si e sukseshme dhe pas ankeses se kompanise Montal (pavarsisht devijimeve ne specifikime teknike) KPP vleresoi si te mireqene faktin e paraqitjes se nje deklarate nga ky operator ekonomik dhe duke hedhur poshte vleresimin e AK, duke shpallur fituese kompanine Montal me nje vlere financiare me te ulet se kompania Medfau SHPK. Vendimi i KPP me numer 903 protokolli date 09.10.2020 me numer vendimi 439/2020 . Duke iu bazuar ketij vendimi ne kerkojme qe KPP te beje te njejtin vleresim duke shpallur si oferte te vlefshme oferten e kompanise tone Medfau SHPK.

Per sa me siper ne kerkojme:

- Ndryshimin e vendimit te Komisionit te vleresimit te Ofertave dhe kualifikimin si oferte te vlefshme dhe fituese te ofertes se kompanise Medfau SHPK (duke qene se eshte oferta me e ulet financiare).*

II.5. Në datën 13.10.2020 operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, për arsyet si më poshtë vijon:

Dokumentacioni i paraqitur për plotësimin e kriterëve të veçanta për kualifikim (KVK) rezulton jo i plotë dhe nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuar në DST, konkretisht:

Pika 2.3, Kapaciteti teknik:

Për sa i përket kesaj pike, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat sipas pikave 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC, të vlefshme, ose ekuivalent, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre. Dhe 2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë për artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për keto artikuj. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit te artikullit ne Formularin e Ofertes dhe te markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikulli i ofruar bashke me specifikimet teknike. (Katalogët duhet të ngarkohen në ëëë.app.gov.al

së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe ne pjeset që kanë lidhje me specifikimet teknike të kerkuara ne DST).

Ne dokumentacioni e paraqitur nga OE rezultojne mungesa, parregullsi dhe mosperputhje si më poshtë:

Për pajisjen CT Skaner 16 slice

Operatori Ekonomik ka deklaruar ne formularin e ofertes që ofron skaner Aquilion Lightning të prodhuesit japonez Canon.

Gjate procesit të vleresimit me qëllim verifikimin e plotesimit të kritereve dhe specifikimeve KVO konstatoi se OE nuk ka deklaruar modelin e skanerit që ka ofruar.

Referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se seria Aquilion Lightning ofron, modelin TSX-035A (16 slice) dhe modelin TSX-036X (80 slice).

OE nuk shprehet se cilin nga këto dy modele ka ofruar dhe ka dorezuar ne tender dokumentet e mëposhtem:

- Deklarim Konformiteti CE për modelin TSX-035A
- Broshure të përgjithshme pa model
- Broshure me disa të dhëna të përgjithshme për modelin TSX-035A
- Katalog për aksesoret të cilët i ka markuar për modelin e përzgjedhur TSX-035A
- Katalogun me specifikime teknike të markuara për modelin TSX-036A (80 slice),

OE nuk ka paraqitur katalog me të dhëna teknike për modelin TSX-035A

Referuar pikës 2.3.5, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC, të vlefshme, ose ekuivalent, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre.

OE ka paraqitur deklaram konformiteti CE lëshuar nga firma prodhuese CANON për modelin TSX-035A, por nuk ka paraqitur certifikatë CE për këtë produkt lëshuar nga një trupë certifikuese siç kërkohet në DST.

OE nuk ka paraqitur certifikatë CE të konformitetit për CT model TSX-036/7 siç kërkohet në DST.

OE ka bërë një deklaratë të tipit Oferte Teknike ku deklaronte specifikime teknike të caktuara, që nuk përputhen me specifikimet teknike të markuara në katalogun e produktit që ka dorezuar në tender. Konkretisht në ofertën teknike deklarohet:

Numri i prerjeve 16

Numri i rreshtave të detektorit 28

Ne katalogun e specifikimeve teknike të dorezuar dhe markuar nga OE nuk paraqitet numri i prerjeve ndërkaq rezulton se numri i rreshtave të detektorit është 80 dhe jo 28 sa është deklaruar ne oferte teknike.

Oferta teknike e përpiluar nga OE ka të dhëna teknike të pa sakta sepse ajo nuk mbështet ne të dhënat e katalogëve të paraqitur.

Oferta e OE ka të dhëna teknike të pasakta, të paplota, pa referenca dhe të pambeshtetura ne kataloget e prodhuesit.

Dokumentacioni i paraqitur rezulton jo i plotë dhe nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në DST.

Per CT skaner 64 slice

Operatori nuk ka paraqitur certifikatë CE siç kërkohet në DST.

OE ka paraqitur deklarin konformiteti CE leshuar nga firma prodhuese CANON per modelin Aquilion Prime SP, por nuk ka paraqitur certifikatë CE për këtë produkt lëshuar nga trupë certifikuese.

Oferta Teknike ka të dhëna teknike të pasakta, të paplota, pa referenca dhe te pambeshtetura ne kataloget e prodhuesit.

Oferta teknike nuk permban pershkrime te detajuara sikurse kerkohet, madje nuk deklarohen as emertimet e produkteve/softwareve dhe as referencat perkatese ne katalog apo dokumente te prodhuesit.

Nga vleresimi i ofertes teknike rezulton se oferta e ofertuar nuk ploteson gjithashtu specifikimet teknike te percaktuara ne specifikimet teknike.

1. Në Dst është kërkuar: Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlere ekuivalente, me permiresim nga softueri), ≥ 30 MHU

Në ofertën teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlere ekuivalente, me permiresim nga softueri), 14 MHU

2. Në Dst është kërkuar: Minimizimi i zhurmes, krahasuar me teknika standarde, deri ne jo me pak se $\geq 90\%$

3. Në ofertën teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Minimizimi i zhurmes, krahasuar me teknika standarde, deri ne jo me pak se 50%

4. Në Dst është kërkuar: Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar për

- Programet kryesore te Konsolit

Teknike per optimizim te vleres se mA dhe rregullim te dozes sipas anatomise se pacientit me ane te modulimit te rrymes ne tubin me rreze-x

Teknike per uljen e dozes ne femije

Teknike per studime angiografike te CT me detektim te bolusit automatik

Teknike per reduktim te artifakteve te shkaktuara nga prania e metaleve ne trupin e pacientit

Teknike per reduktim te zhurmave

Rindertim shumeplanesh ne kohe reale

Rindertim 3D

- Program i specializuar per:

- vleresimin sasiore te patologjive pulmonare,

- segmentimin automatik te mushkerive,

- gjurmim volumetrik te rrugeve te frymemarjes,

- identifikim i perfuzionit lidhur me Embolizmen Pulmonare, Obstuksione Kronike Pulmonare, Emfizeme Pulmonare, etj.

Në ofertën teknike të këtij OE, nuk jane perfshire pershkrime te detajuara për permbushjen e te gjithë specifikimet teknike qe kerkohen. Në oferten teknike nuk deklarohen, nuk pershkruhen dhe nuk jepen referenca me katalogun apo dokumente te tjera të prodhuesit.

Modeli i ofruar ka edhe nje devijim te cilen KVO e konsideron te vogel:

Në Dst është kërkuar: Rezolucioni hapsinor, ne shpejtesine maksimale te rrotullimit (FOV=50cm) ≤ 0.30 mm

Në ofertën teknike të këtij OE, ky specifikim është ofruar: Rezolucioni hapësinor, ne shpejtesine maksimale te rrotullimit (FOV=50cm) 0.31 mm

Dokumentacioni i paraqitur për plotësimin e kriterëve të vecanta për kualifikim (KVK) rezulton jo i plotë dhe nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuar në DST, kokretisht me Kreun

II, seksioni i të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” ku përcaktohet se: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”.

II.5.1. Në datën 20.10.2020 operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me arsyetimin si më poshtë:

[...]

Pretendimet që kanë cuar KVO-ne tuaj të skualifikojë ofertën tonë si dhe argumentimet tona po i rendisim me poshtë:

Per Skanerin 16 Slice, pretendohet:

1. Dokumentacioni i paraqitur për plotësimin e kriterëve të vecanta për kualifikim (KVK) rezulton jo i plotë dhe nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në DST, konkretisht: Pika 2.3, Kapaciteti Teknik. Për sa i përket kësaj pike, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat sipas pikave 2..3..5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktives (MDD ose MDR) 93/42 EEC, të vlefshme, ose ekuivalent, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre.

2. Dhe 2..3..9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloge teknike për artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për këto artikuj. Në kataloge, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyre të ndezur (të verdhe), artikulli i ofruar bashkë me specifikimet teknike. (Kataloget duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe në pjesët që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST).. Në dokumentacionin e paraqitur nga OE rezultojnë mungesa, parregullsi dhe mospërputhje si më poshtë:

Per pajisjen CT Skaner 16 slice, Operatori Ekonomik ka deklaruar në formularin e ofertes që ofron skaner Aquilion Lightning të prodhuesit japonez Canon. Gjate procesit të vlerësimit me qëllim verifikimit të plotësimit të kriterëve dhe specifikimeve, KVO konstatoi se OE nuk ka deklaruar modelin e skanerit që ka ofruar.

Referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se seria Aquilion Lightning ofron, modelin TSX-035A (16 slice) dhe mode/in TSX-036A (80 slice). OE nuk shprehet se cilin nga këto dy modele ka ofruar dhe ka dorëzuar në tender dokumentet e mëposhtme:

- Deklarim Konformiteti CE për modelin TSX-035A*
- Broshurë të përgjithshme për modelin*
- Broshurë me disa të dhëna të përgjithshme për modelin TSX-035A*
- Katalog për aksesoret të cilët i ka markuar për modelin e për zgjedhur TSX-035A*
- Katalogun me specifikime teknike të markuara për modelin TSX-036A (80 slice),*

OE nuk ka paraqitur katalog me të dhëna teknike për modelin TSX-035A

3. Referuar pikës 2.3.5, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktives (MDD ose MDR) 93/42 EEC, të vlefshme, ose ekuivalent, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre. OE ka paraqitur deklaram konformiteti CE leshuar nga firma prodhuese CANON për mode/in TSX-035A, por nuk ka paraqitur certifikate CE për këto produkt leshuar nga

nje trupe certifikuese sig kerkohet ne DST. OE nuk ka paraqitur certificate. CE te konformitetit per CT model TSX-036/A sic kerkohet ne DST.

4. OE ka bere nje deklarate te tipit Oferte Teknike ku deklaron specifikime teknike te caktuara, qe nuk perputhen me specifikimet teknike te markuara ne katalogun e produktit qe ka dorezuar ne tender. Konkretisht ne oferten teknike deklarohet: Numri i prerjeve 16 Numri i rreshtave te detektorit 28. Ne katalogun e specifikimeve teknike te dorezuar dhe markuar nga OE nuk paraqitet numri i prerjeve nderkaq rezulton se numri i rreshtave te detektorit eshte 80 dhe Jo 28 sa eshte deklaruar ne oferte teknike. Oferta teknike e perpiluar nga OE ka te dhena teknike te pa sakta sepse ajo nuk mbeshet ne te dhenat ne katalogeve te paraqitur. Oferta e OE ka te dhena teknike te pasakta, te paplota, pa referenca dhe te pambeshtetura ne kataloget e prodhuesit.

Fillimisht perpara se te fillojme me argumentimin tone, duam te ju bejme me dije se eshte mjaft e qarte arsyeja e skualifikimit te ofertave nga 5 pjesemarrese dhe per me teper se 3 nga keto kishin cmimin me te ulet. Kuptohet se i vetmi qellim eshte kualifikimi i Montal SHPK i cili jo rastesisht ka "pushtuar" te gjitha tenderat e zhvilluar nga Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale per te cilin ishin parapergatitur te gjitha specifikimet teknike qe perpara se te publikohet tenderi. Le te kalojme ne ankimin tone:

Për sa i perket pretendimeve tuaja lidhur me dokumentacionin e paraqitur per Skaner 16 Slice, fillimisht ju bejme me dije se nuk keni treguar aspak te kujdesshem ne menyren se si ju i keni shprehur pretendimet tuaja pasi shpeshhere ato jane kontradiktore si dhe te pabazuara se pari ne kerkesat e vete AK ne DST dhe se dyti te pa bazuara ne legjislacioni e prokurimit publik.

Ashtu sic edhe ju keni referuar shoqeria jone ka ofruar, mode Jin Aquilion Lightning te prodhuesit japonez Canon dhe pretendimi juaj qe vinte pak me vone ku shpreheshit se KVO konstatoi se OE nuk ka deklaruar modelin e skanerit qe ka ofruar eshte krejtesisht kontradiktor dhe i pabazuar.

Ne kriteret e vecanta per kualifikim dhe ne shtojcen 10 AK kishte percaktuar:

Specifikimet teknike

Kerkesen per kataloge teknike per artikujt e ofertuar ku te jene te pasqyruara specifikimet teknike te kerkuara per keto artikuj. Ne kataloge, duhet te shenohet sipas numrit te artikullit ne Formularin e Ofertes dhe te markohen me ngjyre te ndezur (te verdhe), artikulli i ofruar bashke me specifikimet teknike. (Kataloget duhet te ngarkohen ne www.app.gov.al se bashku me dokumentacionin e kerkuar ne keto DT. Pershkrimi teknik duhet te jete i perkthyer ne gjuhen shqipe ne pjeset qe kane lidhje me specifikimet teknike te kerkuara ne DST).

Kerkesen per paraqitjen e Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktives (MDD ose MDR) 93/42 EEC, te vlefshme, ose ekuivalent, per artikujt e ofruar, sipas kategorizimit te tyre.

Per pajisjen Skaner 16 Slice te kerkuar, Ne kemi ofruar pajisjen Skaner 80 Slice Aquilion Lightning TSX-036A/7. Sipas kerkeses tuaj, ne kemi paraqitur katalogun e pajisjes i cili eshte i perkthyer, noterizuar dhe markuar rregullisht sipas kerkeses tuaj i cili gjendet ne materialin e emertuar Aquillon Lightning 16 Slice- Compressed duke filluar nga fq 108 deri ne 143.

Pra pretendimi juaj se ne dokumentacioni e paraqitur nga OE rezultojne mungesa, parregullsi dhe mosperputhje, nuk qendron.

Markimi i Broshures me disa te dhena te pergjithshme per modelin TSX-035A, Katalogut per aksesoret te cilet i ka markuar per modelin e perzgjedhur TSX-035A eshte nje "lapsus" nje "fakt i paqenesishem" gjate markimit ku ne vend te TSX 036A kemi markuar nje fraze te vetme "emertimin" TSX 035. E gjitha pjesa tjeter e markimit eshte ne perputhje me specifikimet teknike qe i referohen modelit TSX A36.

Sa per te ju bere nje shpjegim te vogel, ne kishim menduar te futeshim me model TSX 035 A per Skanerin 16 Slice por duke qene se kishte 2 "mangesi" te vogla ne krahasim me modelin GE te kerkuara ne DST u detyruam te vazhdonim me pajisjen Skaner 80 Slice ne vend te asaj 16 qe kerkohet.

Pra ju do perfitoni dy pajisje 80 Slice edhe me te mire se ato me 64 Slice qe ishin pjese te prokurimit. Lehtesisht e kuptueshme se ju do perfitoni pajisje shume me te mire dhe me cmim me te ulet.

Pervec katalogut i cili eshte i perkthyer, noterizuar, markuar ne perputhje te plote me kriterin kualifikues parashikuar ne DST, ne gjithashtu kemi paraqitur vete Oferten Teknike ku pasqyrohen te gjitha specifikimet e pajisjes 80 Slice qe kemi ofertuar duke ju referuar modelit TSX036A.

Perseri edhe kjo nje prove tjeter per KVO-ne tuaj per te kuptuar se cfare modeli kemi ofertuar meqenese ishte bere konfuze, analizonte ne menyre siperfaqesore pa u thelluar ne detaje.

Ne fakt, nuk e kuptojme fare se si mund te behet konfuze KVO juaj per te mos kuptuar se cfare eshte ofertuar pasi edhe Oferta Teknike e pergatitur nga neve edhe katalogu i pajisjes qe mban te dhena specifike i referohen modeli Aguilon Lighting TSX 036A.

Gjithsesi ligjvenesit ka parashikuar edhe raste te tilla kur KVO ka paqartesi dhe ju ka dhene mundesine per te qartesuar mendimet dhe bindjet e veta duke i kerkuar sqarime operatorit ekonomik.

LPP, neni 53, "Shqyrtimi i Ofertave" pika 1 e tij parashikon: Autoriteti kontraktor, kur e shikon te arsyeshme, u kerkon ofertuesve sqarime per ofertat e tyre, per shqyrtimin, vleresimin dhe krahasimin sa me te drejte te ketyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara ne nenet 32 dhe 33 te ketij ligji, nuk duhet te kerkohet, ofrohet apo lejohet asnje ndryshim ne permbajtjen e ofertes, perfshire ndryshimet ne cmim apo ndryshime qe synojne te kthejne nje oferte te pavlefshme ne te vlefshme.

Referuar dispozites se sipercituar nese AK do donte te kryente nje vleresim sa me te drejte te ofertave dhe nese eshte ndjere vertet konfuze dhe nuk ka dalluar modelin e pajisjes se ofruar atehere mund te shfrytezonte kete mundesi qe ligjvenesit i ka vendosur ne dispozicion duke na kerkuar sqarimet perkatese dhe jo te tejkalohte kete hap kaq te rendesishem duke na skualifikuar. Per me teper, jo vetem se e tejkalon kete hap kaq te rendesishem pasi nese do ishte realizuar si hap atehere nuk do te skualifikoheshim por per te vazhduar me tej, institucioni juaj ka kaluar te ofertuesit i renditur pas BNT me nje oferte prej afersisht 14.000.000 leke me te shtrenjte. Ky veprim bie ndesh dhe shume rende me vete qellimin e ligjit qe i cili eshte te miremenxhoje fondet publike dhe buxhetin e shtetit. KVO ka nxituar per te skualifikuar nje oferte te vlefshme per te kaluar tek nje oferte e cila ishte e parapercaktuar dhe madje kete e ka bere duke e vleresuar edhe pse kishte cmimin me te larte.

Per sa i perket numrit te shprehur jo sakte te rreshtave te detektorit, sic mund ta vini re dhe ju, ne kemi ofruar nje sistem shume me te mire sesa ai qe kerkohej ne DST; Vendosja jo sakte nga ana jone e numrit te rreshtave te detektorit nuk eshte bere per ti shtuar vleren ne menyre ne padrejte sistemit qe ne ofrojme, perkundrazi sistemi yne eshte shume me i mire sesa eshte kerkuar. Kerkojme qe ky lapsus te mos jete faktor skualifikues ne tender. Pavaresisht ketij lapsusi, pajisja jone i sherben me shume interesit publik duke qene se eshte cilesi shume me e mire nga se eshte kerkuar.

Per sa i perket CE se paraqitur per modelin TSX 035A, JU sqarojme kjo CE eshte hedhur gabimisht ne vend te CE per modelin TSX036A kjo per arsyen qe ju shpjeguam me larte. Pra ne

kishim planifikuar te futeshim me kete model por pasi konstatuam se kishte disa "mangesi" krahasuar me ate cfare ishte kerkuar u detyruam te ofertonim Skaner 80 Slice ne vend te atij 16 Slice te kerkuar.

Per pasoje ky eshte nje dokument teper i paraqitur ne tender i cili nuk mund te merret ne shqyrtim per ta vleresuar pasi neve nuk kemi ofertuar ate model, nuk kemi paraqitur as oferte teknike apo katalog per ate model ashtu sic edhe ju keni deklaruar ne pretendimet tuaja per skualifikim. Per pasoje nje dokument i paraqitur me teper dhe qe ska lidhje me obejktin e tenderit nuk kemi pse te merremi me shtjellimin e ceshtjes.

Nderkohe lidhur me pretendimin tuaj se OE nuk ka paraqitur certificate CE te konformitetit per CT model TSX-036/A sic kerkohet ne DST ju bejme me dije se vertete rezulton te mungoje ky dokument fizik por nderkohe ju keni marre dijeni qe kjo pajisje eshte konform direktivave te Keshillit European qe duhet te jete ne perputhje me to. Kjo, jo vetem se as nuk diskutohet perputhshmëria e cilesise nga prodhuesi Japonez Canon por mbi te gjitha kete informacion e keni gjetur edhe ne katalogun e pajisjes i cili eshte i markuar me te "verdhe" ku shpreh qartazi se kjo pajisje eshte ne perputhje me direktivat e Keshillit Evropian dhe amendimet vijuese:

IEC 60601-2-44:2009+Amd. 1: 2012+Amd 2. 2016

IEC 60601 - 1: 2005 + Amel 1: 2012

IEC 60601-1-2:2014

IEC 60601-1-3: 2008+ Amd 1. 2013

IEC 60601 -1 -6: 2010+ Amell.: 2013

IEC 60601-2:28:2010

IEC 60825-1:2007

IEC62366:2007+Amd:2014

IEC 62304:2006+Amd.1: 2015

(shiko katalogun e markuar dhe te uploaduar ne system)

Pervec se si me larte, ju moret dijeni qe pajisja eshte ne perputhje te plote me direktivat evropiane ne gjithashtu po ju bashkengjisim dokumentin CE per pajisjen model TSX 036A te perkthyer dhe noterizuar sipas kerkeses tuaj.

Sjellim ne vemendjen tuaj se kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per perrnbushjen me sukses te kontrates dhe se Autoriteti kontraktor nuk duhet te gjykoje ne menyre siperfaqesore e formale, por te analizoje ne themel dhe ne menyre te arsyeshme e proporcionale kapacitetet e dokumentuara nga ofruesit/kandidatet, ne funksion te qellimit dhe rrethanave faktike per te cilin vendosen kriteret e percaktuara dhe vecanerisht nuk duhet te shikojne ne menyre siperfaqesore dokumentet qe leshohen nga vete autoriteti kontraktor.

Bashkengjitur kesaj ankese po ju dergojme CE te perkthyer i noterizuar.

Ne botimit e SIGMA-OECD "Vendime gjyqesore te perzgjedhura te Gjykates se Drejtesise se BE per prokurimin publik (2006-2014)", lexojme se ne Ceshtjen C-336/12 Manova, "GjD-ja arriti ne perfundimin se autoriteti kontraktues mund te kerkonte ndreqjen ose amplifikimin e detajeve te aplikimit mbeshetur ne nje arsye te kufizuar dhe te vecante, Ky amendament lejohet per aq kohe sa kerkesa ka te beje me detaje ose informacione qe tregojne objektivisht se i perkasin periudhes para dates se skadimit te afatit te fundit per dorezimin e aplikimeve (paragrafi 39). GjD-ja gjithashtu theksoi nje kusht thelbesor: kerkesa per informacionin qe mungon nuk duhet te favorizojte padrejtesisht apo t'i krijojte disavantazhe kandidatit ne fjale (paragrafi 42). GjD-ja i

zbatoi keto kushte ndaj fakteve ne Ceshtjen C-336/12 Manova. Aja konfirmoi se bilancet ekzistonin tashme dhe ishin publikuar para paraqitjes se aplikimit. Aja arriti ne perfundimin se me pranimin e kopjeve te bilanceve pas dates se aplikimit autoriteti kontraktues nuk kishte shkelur parimin e trajtimit te barabarte. "

Ne kuptim te nenit 116 te Kushtetutes dhe "Marreveshjes se Stabilizim Asociimit Ndermjet Komuniteteve Europiane E Shteteve Te Tyre Anetare Dhe Republikes Se Shqiperise", neni 70 i se ciles parashikon se: "Palet njohin rendesine e perafimit te legjislacionit ekzistues shqiptar me ate te Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqiperia do te perpiqet te siguroje qe ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshem te shkoje gradualisht drejt perputhjes me acquis e Komunitetit. Shqiperia do te siguroje qe legjislacioni ekzistues dhe i ardhshem te zbatohet dhe imponohet si duhet", Komisioni i Prokurimit Publik i referohet jurisprudences se Gjykates se Drejtesise se BE ne vendimmarrjen e tij.

Lidhur me trajtimin e ceshtjeve ten je natyre te tille, ju lutem referojuni dhe vete vendimeve te K.P.P.613/2014 dhe K.P.P.664/2016 te Komisionit te Prokurimit Publik si institucioni me i larte administrativ ne fushen e prokurimeve publike ku ky I fundit ka pranuar ankesat e operatoreve ekonomik.

Per sa i perket pretendimit tuaj lidhur me trupin certifikues te CE-se ju rikojtojmë se kriteri kualifikues parashikuar ne dst ishte: Operatori Ekenomik paraqitjen e Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktives (MDD ose MDR) 93/42 EEC, te vlefshme, ose ekuivalent, per artikujt e ofruar, sipas kategorizimit te tyre. Sic verehet qartazi, ne asnje rast kerkesa nuk shpreh se se Certifikata duhet te jete e leshuar nga nje trup certifikues thjeshte kerkon te jete ne perputhje me direktivat MDD ose MDR 93/42 EEC. Ne kuptimin e kesaj kerkesë, CE qe ne po Bashkengjisim eshte ne perputhje te plote me kerkesat e AK ne DST.

Per pasoje Ak nuk mund te na skualifikoje per kete arsye pasi Ligji i Prokurimit Publik, neni 53 "Shqyrtimi i Ofertave" pika 3 parashikon: Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetern nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij ligji. Ne rastin konkret CE e bashkengjitur eshte ne perputhje te plote me kerkesat e specifikuara në njoftimin e kontrates dhe me DST.

Si perfundim, nje paqartesi e juaja mbi modelin e pajisjes nuk duhej te conte ne skualifikim. Ju duhet te kishit ndjekur rrugen ligjore per t'u qartesuar duke na drejtuar nje kerkes per sqarim ashtu sic parashikon ligji dhe jo te kapercenit kete hap kaq te rendesishem duke nxituar me qellim kualifikim e ofertes se paraqitur nga operatori i "preferuar" madje dhe me nje diference me te larte prej afërsisht 14.000.000 leke me shtrenjte duke i shkaktuar dem buxhetit te shtetit.

Ne nje kohe, kur ju do te merrnit nje pajisje 80 Slice me vleren e asaj 16 Slice.

Asnje nga pretendimet tuaja nuk perbejne kusht per skualifikim per pasoje pretendimet tuaja nuk qendrojnë.

Per Skanerin 64 Slice, pretendohet:

1. Dokumentacioni i paraqitur rezulton jo i plote dhe nuk eshte ne perputhje me kerkesat e percaktuar ne DST. Per CT skaner 64 slice Operatori nuk ka paraqitur certifikate CE sic kerkohet ne DST OE ka paraqitur deklarim konformiteti CE leshuar nga firma prodhuese CANON per modelin Aquilion Prime SP, por nuk ka paraqitur certifikate CE per kete produkt leshuar nga trupe certifikuese.

2. *Oferta Teknike ka te dhena teknike te pasakta, te paplota, pa referenca dhe te pambeshtetura ne katalogët e prodhuesit. Oferta teknike nuk permban pershkrime te detajuara sikurse kerkohet, madje nuk deklarohen as emertimet e produkteve/softuerëve dhe as referencat perkatese ne katalog apo dokumente te prodhuesit. Nga vleresimi i ofertes teknike rezulton se oferta e ofertuar nuk ploteson gjithashtu specifikimet teknike te percaktuara ne specifikimet teknike.*

- Ne Dst eshte kerkuar: Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlere ekuivalente, me permiresim nga softueri), 30 MHU Ne oferten teknike to ketij OE, ky specifikim eshte ofruar: Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlere ekuivalente, me permiresim nga softueri), 14 MHU

- Ne DST eshte kerkuar: Minimizimi i zhurmes, krahasuar me teknika standarde, deri ne Jo me pak se 90%. NE oferten teknike te ketij OE, ky specifikim eshte ofruar: Minimizimi i zhurmes, krahasuar me teknika standarde, deri ne jo me pak se 50%.

3. *Ne DST eshte kerkuar: Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar per - Programet kryesore te Konsolit Teknike per optimizim te vleres se mA dhe rregullim te dozës sipas anatomise se pacientit me ane te modulimit te rrymes ne tubin me rreze-x Teknike per uljen e dozës ne femije Teknike per studime angiografike te CT me detektim te bolusit automatik Teknike per reduktim le artifakteve te shkaktuara nga prania e metaleve ne trupin e pacientit Teknike per reduktim te zhurmave Rindertim shumeplanesh ne kohe reale Rindertim 3D - Program i specializuar per: - vleresimin sasior te patologjive pulmonare, - segmentimin automatik te mushkerive, - gjurnim volumetrik te rrugeve te frymemarjes, - identifikim i perfuzionit lidhur me Embolizmen Pulmonare, Obstuksione Kronike Pulmonare, Emfizeme Pulmonare, etj.*

NE oferten teknike te ketij OE, nuk jane perfshire pershkrime te detajuara per permbushjen e te gjithë specifikimeve teknike qe kerkohen. Ne oferten teknike nuk deklarohen, nuk pershkruhen dhe nuk jepen referenca me katalogun apo dokumente te tjera te prodhuesit. Modeli i ofruar ka edhe nje devijim te cilen KVO e konsideron te vogel: NE Dst eshte kerkuar: Rezolucioni hapësinor, ne shpejtesine maksimale te rrotullimit (FOV=50cm) 5 0.30 mm NE oferten teknike to ketij OE, ky specifikim eshte ofruar: Rezolucioni hapësinor, ne shpejtesine maksimale te rrotullimit (FOV=50cm) 0.31 mm.

Dokumentacioni i paraqitur per plotesimin e kriterëve te vecanta per kualifikim (KVK) rezulton Jo i plote dhe nuk eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat e percaktuara ne DST, konkretisht me Kreun, seksioni i te dokumentëve te tenderit "Udhëzime per operatoret ekonomike" ku percaktohet se: "Operatoret Ekonomike jane te detyruar te pergatisin oferta, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne keto DT Ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto DT do te refuzohen si te papranueshme".

Per sa i perket pretendimit tuaj lidhur me Ce, nuk qendron. Kjo per arsye se ne kemi paraqitur Ce e ketij produkti ne Filin e emertuar "Dokumenta Ligjor 7" per model in TSX- 303 B (Aguillon Prime SP). ky dokument eshte i perkthyer, noterizuar ne perputhje te plote me kerkesen tuaj.

Per sa i perket pretendimit tuaj lidhur me trupin certifikues te CE-se ju rikujtojme se kriteri kualifikues parashikuar ne dst ishte: Operatori Ekonomik paraqitjen e Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktives (MDD ose MDR) 93/42 EEC, te vlefshme, ose ekuivalent, per artikujt e ofruar, sipas kategorizimit te tyre. Sic verehet qartazi, ne asnje rast kerkesa nuk shpreh se Certifikata duhet te jete e leshuar nga nje trup certifikues thjeshte kerkon te jete ne perputhje me direktivat MDD ose MDR 93/42 EEC. Ne kuptimin e kesaj kerkesë, CE qe ne po Bashkengjisim eshte ne perputhje te plote me kerkesat e AK ne DST.

Per pasoje Ak nuk mund te na skualifikoje per kete arsye pasi Ligji i Prokurimit Publik, neni 53 "Shqyrtimi i Ofertave" pika 3 parashikon: Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij ligji. Ne rastin konkret CE e bashkengjitur eshte ne perputhje te plote me kerkesat e specifikuara ne njoftimin e kontrates dhe me DST.

Lidhur me oferten teknike, ky eshte nje dokument i paraqitur ekstra nga neve jo se ishte kriter kualifikues sipas DST. Ne kete dokument ne kemi bere pershkrim te detajuar te elementeve te kerkuar nga ju por ju nuk kishit dhene nje shembull mbi detajimin e kerkesve se si e kerkonit. Ne keto kushte ne kemi detajuar te sakte dhe te plote informacionin e kerkuar ze per ze.

Per sa i perket Kapaciteti i nxehtesise maximal i llampes habitemi me pretendimin tuaj absurd pasi dihet se ne ditet e sotme perdoren skanera me kapacitet nxehtesie me te ulet por qe kryejne rikonstruksion perserites (iterative reconstruction) dhe doze rrezatimi me te ulet.

Fuqia e nevojshme e rrezatimit eshte me e ulet dhe detyrimisht kapaciteti i nxehtesise synohet te jete me i ulet ne rast kur perdoren teknika te avancuara rikonstruksioni. Skaneri i ofruar nga ne ka nje cooling rate shume me te mire nga ckeni kerkuar ju, ndaj nuk eshte e nevojshme qe te kete kapacitet ngrohes me shume se 14MHU. Reduktimi i nxehtesise ne anode ndikon ne rritjen e jetegjatesise se llampes se rrezeve X.

Lidhur me minimizimin e zhurmes: Ne oferten teknike kemi shprehur: Minimizimi i zhurmes krahasuar me teknika standarde >90%.

Pra pretendimi juaj nuk qendron.

Lidhur me pretendimin tuaj per pershkrimin e detajuar te specifikimeve:

Per te gjitha softet dhe teknikat perkatese kemi paraqitur te markuar me te verdhe te gjitha funksionet qe i perkasin kerkesave te paraqitura ne tender.

- Programet kryesore te Konsolit Teknike per optimizim te vleres se mA dhe rregullim te dozesh sipas anatomise se pacientit me ane te modulimit te rrymes ne tubin me rreze-x SUREExposure & SUREkV

- Teknike per reduktim te artifakteve te shaktuara nga prania e metaleve ne trupin e pacientit - Single Energy Metal Artifact Reduction (SEMAR)

- Teknike per reduktim te zhurmave - Pure Vision

- Rindertim shumeplanesh ne kohe reale - MPR

- Rindertim 3D ne faqen 7 te katalogut me specifikime teknike shprehet: 3D color image processing (surface rendering, volume rendering, MPR, curved MPR, MIP, cine)

- Program i specializuar per: - vleresimin sasior te patologjive pulmonare, - segmentimin automatik te mushkerive, - gjurmim volumetrik te rrugeve te frymemarjes, - identifikim i perfuzionit lidhur me Embolizmen Pulmonare, Obstuksione Kronike Pulmonare, Emfizeme Pulmonare Vitrea CT Lung Package Lung volume analysis (CSLV-OOIA)

Pra edhe ky pretendim i juaj i nuk qendron.

Lidhur me specifikimin Teknik te cilin e keni konsideruar devijim te vogel, eshte ekzaktesisht nje devijim i cili nuk mund te merret ne konsiderate pasi nuk ka ndikim mbi performance dhe funksionalitetin e pajisjes. Vete LPP, neni 53, pika 4 shprehet se: Autoriteti kontraktor vlereson nje oferte te vlefshme eclhe nese ajo permban devijime te vogla, te argumentuara, te cilat nuk

ndryshojne thelbesisht karakteristikat, kushtet dhe kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, te cilat mund te korrigojohen pa prekur permbajtjen e saj.

Perseri, konkludojme se asnje nga pretendimet tuaja nuk qendrojne dhe per pasoje nuk perbejne kusht per skualifikim.

Ne ju kemi ofruar pajisje me 80 Slice ne vend te asaj 16 Slice te kerkuar si dhe pajisje tjeter me 80 Slice ne vend te asaj 64 Slice te 80 Slice te kerkuar. Absolutisht keto pajisje jane ne nje nivel Teknik shume here me te larte nga se eshte kerkuar, kjo e dokumentuar dhe e provuar me dokumentacionin Teknik te aploduar ne SPE te cilin ju e keni verifikuar.

Ajo cfare eshte e rendesishme, eshte fakti se te dyja keto pajisje te nje nivelin tepër te larte teknik, ju do ti merrni me cmimin e ofertuar ne oferte i ishte referuar fondit qe ju keni parashikuar per Skanera te nje niveli shume here me te ulet Teknik te cilet jane kerkuar ne tender.

Akoma edhe me i rendesishem eshte fakti se se nuk mund te skualifikohet nje oferte e cila eshte ne perputhje te plote me kerkesat ligjore dhe ne perputhje te plote me kerkesat teknike madje ne kete rast shume shkalle me larte nga se eshte kerkuar me qellim qe ju te kualifikoni nje operator tjeter me nje pajisje me nivel me te ulet Teknik se sa ate qe ne ju kemi ofruar dhe me nje cmim afersisht 14.000.000 leke me te shtrenjte se sa oferta jone.

Ky hap i ndermarre nga KVO, eshte i pajustificueshem, ne shkeije te plote te vete qellimit te ligjit qe ka per qellim te miremenaxhoje fondet publike dhe ne te njejten kohe te prokuroje pajisjen e kerkuar apo dhe ne nivel me te larte sesa eshte kerkuar.

Per sa me larte, kerkojme kualifikimin e ofertes tone e cila eshte ne perputhje te plote me kerkesat e AK ne DST dhe me legjislacionin e prokurimit publik.

II.5.2. Në datën 22.10.2020, me shkresën nr. 3403/38 prot, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar ankesën në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit. Ndërkohë që operatori ekonomik ankimues, pretendon se ka marrë dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së tij, në datë 26.10.2020. Konkretisht autoriteti kontraktor në kthim përgjigje ka argumentuar:

[...]

III. Komisioni i ngarkuar per shqyrtimin e ankesave dhe dhënien e vendimit pas shqyrtimit te tyre dhe dokumentacionit qe disponon ne lidhje me proceduren e mesiperme te prokurimit,

Arsyeton:

III.1. Per pajisjen Skaner 16 Slice te kerkuar:

• Komisioni pasi beri verifikimet e nevojshme, duke garantuar parimin e barazise, konkurrencës dhe mosdiskriminimit te percaktuar ne ligjin e prokurimeve sqaron se KVO ka vleresuar se Operatori Ekonomik ka deklaruar ne formularin e ofertes qe ofron skaner Aquilion Lightning te prodhuesit japonez Canon duke deklaruar dy modele.

Referuar dokumentacionit te paraqitur rezulton se seria Aquilion Lightning ofron, modelin TSX-035A (16 slice) dhe modelin T X-036X (80 slice).

OE ankimues nuk shprehet qarte se cilin nga keto dy modele ka ofruar dhe ka dorezuar ne tender dokumentet e meposhtme:

- Deklarim Konformiteti CE per modelin TSX-035°
- Broshure te pergjithshme pa model
- Broshure me disa te dhena te pergjithshme per modelin TSX-035°
- Katalog per aksesoret te cilet i ka markuar per modelin e perzgjedhur TSX-035°

- Katalogun me specifikime teknike te markuara per modelin TSX-036A (80 slice), Vete OE ankimes, pranon se ka Markuar Broshure me disa te dhena te pergjithshme per modelin TSX-035A. Katalogut per aksesoret te cilet i ka markuar per modelin e perzgjedhur TSX-035/A eshte nje "lapsus" gjate markimit ku ne vend te TSX 036° kemi markuar nje fraze te vetme "emertimin" TSX 035 dhe e gjitha pjesa tjeter e markimit eshte ne perputhje me specifikimet teknike qe i referohen modelit TSXA36.

Oe sqaron se Oferta Teknike ku pasqyrohen te gjitha specifikimet e pajisjes 80 Slice qe kemi ofertuar duke ju referuar modelit TSX 036A proven modelin qe kerkohet te ofertohe.

Ne fakt, nuk e kuptojme fare se si mund te behet konfuzo KVO juaj per te mos kuptuar se cfare eshte ofertuar pasi edhe Oferta Teknike e pergatitur nga neve edhe katalogu i pajisje qe mban te dhena specifike i referohen modeli Aquillon Lighting TSX 036A.

Komisioni sqaron se KVO ka konstatuar keto parregullsi per shkak te lapsuve te vete OE Ankimes dhe eshte ne tagrin e KVO te vleresojte rast mbi rast mbi nevojten per sqarime nga OE pjesemarrës. III. 2. "Per sa i perket numrit te shprehur jo sakte te rreshtave te detektorit

Komisioni pasi beri verifikimet e nevojshme, duke garantuar parimin e barazise, konkurrencës dhe mosdiskriminimit të përcaktuar ne ligjin e prokurimeve sqaron se dokumentacioni i ngarkuar ne SPE nga OE pjesemarrës nuk eshte plotesuar ne perputhje me kerkesat e Dst, per aq kohe sa vete OE pranon plotesimin me gabime te te dhenave.

Konkretisht: OE ka bere nje deklarate te tipit Oferte Teknike ku deklaronte specifikime teknike te caktuara, qe nuk perputhen me specifikimet teknike te markuara ne katalogun e produktit qe ka dorezuar ne tender. Konkretisht ne oferten teknike deklarohet:

Numri i prerjeve 16

Numri i rreshtave te detektorit 28

Ne katalogun e specifikimeve teknike te dorezuar dhe markuar nga OE nuk paraqitet numri i prerjeve nderkaq rezulton se numri i rreshtave te detektorit eshte 80 dhe jo 28 sa eshte deklaruar se oferte teknike. Oferta teknike e perpiluar nga OE ka te dhena teknike te pasakta sepse ajo nuk mbeshetet ne te dhenat e katalogeve te paraqitur. Oferta e OE ka te dhena teknike teknike te pasakta, te paplota, pa referenca dhe te pambeshetura ne kataloget e prodhuesit. Dokumentacioni i paraqitur rezulton jo i plote dhe nuk eshte ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne DST. Sa me siper ky pretendim nuk qendron.

III.3. Per sa i perket CE se paraqitur per modelin TSX 035A

-Komisioni pasi beri verifikimet e nevojshme, duke garantuar parimin e barazise, konkurrencës dhe mosdiskriminimit te percaktuar ne ligjin e prokurimeve sqaron se, referuar pikes 2.3.5, operatori ekonomik duhet te paraqesë Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktives (MDD ose MDR) 93/42 EEC, te vlefshme, ose ekuivalent, per artikujt e ofruar, sipas kategorizimit te tyre.

OE ka paraqitur deklarim konformiteti CE leshuar nga firmat prodhuese CANON per modelin TSX-035A por nuk ka paraqitur certifikate CE per kete produkt leshuar nga nje trupe certifikuese sic kerkohet ne DST.

OE nuk ka paraqitur certifikate CE te konformitetit per CT model TSX-036/7 sic kerkohet ne DST. Gjithashtu sqarojme se dokumente shtese nuk mund te ngarkohen nga OE ankimes per arsye se KSHA mund te shqyrtoje ankesen vetem mbi dokumentacionin e ngarkuar ne SPE mbas hapjes se ofertave ne perputhje me neni 53 pika I i LPP. Sa me siper ky pretendim nuk qendron.

III.4 Per Skanerin 64 Slice, Per sa i perket CE se paraqitur per modelin TSX- 303 B (Aquillon Prime SP):

- Komisioni pasi beri verifikimet e nevojshme duke garantuar parimin e barazise, konkurrencës dhe mosdiskriminimit te percaktuar ne ligjin e prokurimeve sqaron se, Operatori nuk ka paraqitur certifikate CE sic kerkohet ne DST.

OE ka paraqitur deklarim konformiteti E leshuar nga firma prodhuese CANON per modelin Aquilion Prime SP, por nuk ka paraqitur certifikate CE per kete produkt leshuar nga trupe certifikuese, fakt i pranuar nga vete ai.

Sa me siper ky pretendim nuk qendron.

III.5. Lidhur me kriteret "Kapaciteti ngrohes i Andes" dhe "Minimizimi i zhurmes, krahasuar me teknikat standarde":

-Komisioni pasi beri verifikimet e nevojshme duke garantuar parimin e barazise, konkurrencës dhe mosdiskriminimit te percaktuar ne ligjin e prokurimeve sqaron se, nga vleresimi i ofertes teknike rezulton se oferta e ofertuar nuk plotëson specifikimet teknike te percaktuara ne specifikimet teknike.

1. Ne DST eshte kerkuar: Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlere ekuivalente, me permiresim nga softueri), ≥ 30 MHU

Ne oferten teknike te ketij OE ky specifikim eshte ofruar: Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlere ekuivalente, me permiresim nga softueri), 14 MHU

2. Ne Dst eshte kerkuar: Minimizimi i zhurmes, krahasuar me teknika standarde, deri ne jo me pak se $\geq 90\%$

3. Ne oferten teknike te ketij OE ky specifikim eshte ofruar: Minimizimi i zhurmes, krahasuar me teknika standarde, deri ne jo me pak se 50 %

Vete OE pjesemarrës ne kete procedure e pranon mosplotesimin e ketyre speciflkimeve teknike, duke mos permbushur Kriteret e vecanta te kualifikimit.

Sa me siper ky pretendim nuk qendron.

Sa me lart, Komisioni i ngarkuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor per shqyrtimin e ankeses dhe dhenien e vendimit ka vendosur te mos pranoje ankesen e paraqitur nga operatori ekonornik "BNT Electronics" SHPK per proceduren e prokurimi; "F.V Pajisje mjekesore -CT Scanner", fondi limit 144,112,500 (njqind e dyzet e kater milion e njqind e dymbedhjete mije e peseqind) Leke pa TVSH. REF-67482-07-31-2020.

II.5.3. Në datën 02.11.2020 operatori ekonomik "BNT Electronis" SHPK. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor. Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon:

[...]

Me poshte po rendisim faktet, "arsyet" e skualifikimit dhe pretendimet tona te argumentuara dhe provuara ne perputhje me frymen e legjislacionit te prokurimit publik.

Fillimisht ju bejme me dije se procedura e ketij tenderimi eshte bere per prokurimin e pajisjeve mjekesore si me poshte:

- Scaner 16 Slice (2 cope)
- Scaner 64 slice (1 cope)

BNT Electronicsh SHPK, ka marre pjese ne kete procedure prokurimi duke ofertuar Scannera 80 Slice per te dyja variantet e kerkuara. Pra ne kemi marre pjese ne gare duke ofertuar pajisje ne nje nivel teknik shume me te larte nga sa kerkohet dhe ne te njejten kohe me nje vlere relativisht

te ulet, pasi per Skanerët 80 Slice normalisht duhet nje fond me i larte se sa per Skanerët 16 dhe 64 Slice.

Sjellim ketu ne vemendjen tuaj, se Skaneri eshte nje pajisje qe ka per qellim te ekzaminoje organet e trupit deri ne berthamen e qelizave me sa me pak doze rrezatimi qe pacienti te mos marre doze te tepruar dhe nr. i Sliceve eshte teper i rendesishem per ekzaminimin e pacienteve pasi sa me i larte te jete nr. i sliceve aq me shume ulet doza e rrezatimit tek pacienti dhe kur Skaneri eshte me 80 Slice, ekzaminimi kryhet ne nje nivel teper te larte duke siguruar rezultat teper teper te sigurt mbi ekzaminimin, ne vend te atyre te kerkuar me 16 apo 64 Slice.

Pavaresisht se ne ofertuam 2 Skanerë 80 Slice ne vend te tyre 16 Slice si dhe ofruam 1 Skaner 80 Slice ne vend te atij 64 slice qe kerkoheshin, pra te 3 Skanerat e kerkuar i ofruam 80 Slice, shume here me te mire teknikisht per te realizuar nje ekzaminim shume here me te sakte dhe profesional, perseri KVO e Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes Socile gjeti disa artefakte per te na skualifikuar.

Ne pamje te pare, duke menduar edhe profesionalisht por edhe logjikisht, te skualifikohesh nga nje procedure prokurimi kur nderkohe ke paraqitur pajisje ne nje nivel shume me te larte se sa kerkohet dhe me nje vlere teper te ulet ne krahasim se sa duhej te ofrohej, per ne ishte nje paradoks. Gjithsesi, ne momentin qe verejtem se nga 5 operatore, jane skualifikuar 4 pra vetem 1 operator paska rezultuar ne "perputhje te plote" dhe kjo kompani rezulton te jete Montal SHPK dhe nderkohe eshte renditur e katerta jemi te bindur se skualifikimi jone eshte i padrejte dhe forcon dyshimin tone qe fituesi i tenderit ka qene i paracaktuar.

Sjellim ne vemendjen tuaj se kualifikimi i vetem ketij operatori nuk eshte i rastesishem. Fillimisht, ju rikujtojme se per kete procedure, BNT por edhe shoqeri te tjera kane bere ankese edhe ne KPP perpara se te zhvillohej tenderi per arsye se specifikimet teknike ishin bere pikerisht per produktet GE qe Montal eshte distributor. Nese nuk do te ishte keshtu, asnje nga operoret e mundshem nuk do te harxhonte kohe as para per te ankimuar.

Ne nuk do te ishim ankuar nese nje procedure e tille ku paracaktohet fituesi do te ishte e rastesishme por me keqardhje veme re se kohet e fundit ka patur shume procedura qe paracaktohet fituesi i pajisjeve qe eshte ose GE apo produkt qe eshte po Montal distributor i autorizuar.

Dhe te gjitha keto procedura, kane bere shume pershtypje te Operoret Ekonomike te fushes se pajisjeve mjeksore pasi raste te tilla kane qene sporadike dhe aspak te organizuara ne menyre te tille qe operoret e tjere nuk mund te marrin pjese ne procedure. Theksojme, ne te gjitha keto procedura ka patur ankese nga operoret deri ne KPP, institucionin tuaj, pasi te gjitha keto procedura perfshire kete te Skanerave jane parapërgatitur nga kerkesat teknike per produktin e GE, ofertuar nga Montal SHPK.

Tani le te ju bejme nje permbledhje te renditjes dhe te "arsyeve" qe kanë cuar ne skualifikimin e ofertes tone e cila ishte e renditur e treta por me qellim qe te realizohej plani i MSH, skualifikohen te gjithe edhe sikur te ishin 20 operoret te renditur para Montalit.

Renditja e Operoreve ekonomike pjesemarres, duke u bazuar ne vleren e ofertuar, rezulton si me poshte:

Operatori Ekonomik	Vlera e ofertuar	Refuzuar
Biometric Albania	0.00 Po	
EUROMED	0.00 Po	
MSE	0.00 Po	
MEDFAU	79, 790,000 Po	

Health & Light	80,750,000	Po
BNT Electronics	85,961,928	Po
Montal	99,740,000	Jo
Albaphoto	122,000,000	Po

Pretendimet qe kanë cuar KVO-ne te skualifikoje oferten tone si dhe argumentimet tona po i rendisim me poshte:

Per Skanerin 16 Slice, pretendohet:

1. Dokumentacioni i paraqitur per plotesimin e kriterëve te vecanta per kualifikim (KVK) rezulton jo i plote dhe nuk eshte ne perputhie me kerkesat e percaktuara ne DST, konkretisht: Pika 2.3, Kapaciteti Teknik. Persa i perket kesaj pike, Operatori Ekonomik duhet te përmbushë kerkesat sipas pikave 2.3.5 Operatori ekonomik duhet te paraqese Certifikata konfrmiteti CE ose CE sipas direktives (MDDose MDR) 93/42 EEC, te vlefshme, ose ekuivalent, per artikujt e ofruar, sipas kategorizimit te tyre.

2. Dhe 2.3.9 Operatori ekonomik duhet te paraqese kataloge teknike per artikujt e ofertuar ku te jene te pasqyruara specifikimet teknike te kerkuara per keto artikuj. Ne kataloge, duhet te shenohet sipas numrit te artikullit ne Formularin e Ofertes dhe te markohen me ngjyre te ndezur (te verdhe), artikulli i ofruar bashke me specifikimet teknike. (Kataloget duhet te ngarkohen ne www.app.gov.al se bashku me dokumentacionin e kerkuar ne keto DT Pershkrimi teknik duhet te jet-6 i perkthyer ne gjuhen shqipe ne pjeset qe kane lidhje me specifikimet teknike te kerkuara ne DST). Ne dokumentacioni e paraqitur nga OE rezultojne mungesa, parregullsi dhe mosperputhje si me poshte:

Per pajisjen CT Skaner 16 slice, Operatori Ekonomik ka deklaruar ne formularin e ofertes qe ofron skaner Aquilion Lightning to prodhuesit japonez Canon. Gjate procesit te vleresimit me qellim verifikimin e plotesimit te kriterëve dhe specifikimeve, KVO konstatoi se OE nuk ka deklaruar modelin e skanerit qe ka ofruar.

Referuar dokumentacionit te paraqitur rezulton se seria Aquilion Lightning ofron, modelin TSX-035A (16 slice) dhe mode/in TSX-036A (80 slice). OE nuk shprehet se cilin nga keto dy modele ka ofruar dhe ka dorezuar ne tender dokumentet e meposhtem:

- Deklarim Konfomiteti CE per modelin TSX-035A
- Broshure te pergjithshme pa model
- Broshure me disa te dhena te pergjithshme per modelin TSX-035A
- Katalog per aksesoret te cilet i ka markuar per modelin e perzgjedhur TSX-035A
- Katalogun me specifikime teknike te markuara per modelin TSX-036A (80 slice),

OE nuk ka paraqitur katalog me te dhena teknike per modelin TSX-035A

3. Referuar pikes 2.3.5, Operatori ekonomik duhet te paraqese Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktives (MDD ose MDR) 93/42 EEC, te vlefshme, ose ekuivalent, per artikujt e ofruar, sipas kategorizimit te tyre. OE ka paraqitur deklarim konformiteti CE leshuar nga firma prodhuese CANON per modelin TSX-035A, por nuk ka paraqitur certifikate CE per kete produkt leshuar nga nje trupe certifikuese sig kerkohet ne DST. OE nuk ka paraqitur certifikate. CE te konformitetit per CT model TSX-036/A sic kerkohet ne DST.

4. OE ka bere nje deklarate te tipit Oferte Teknike ku deklarone specifikime teknike te caktuara, qe nuk perputhen me specifikimet teknike te markuara ne katalogun e produktit qe ka dorezuar ne tender. Konkretisht ne oferten teknike deklarohet: Numri i prerjeve 16 Numri i rreshtave te detektorit 28. Ne katalogun e specifikimeve teknike te dorezuar dhe markuar nga OE nuk paraqitet

numri i prerjeve nderkaq rezulton se numri i rreshtave te detektorit eshte 80 dhe Jo 28 sa eshte deklaruar ne oferte teknike. Oferta teknike e perpiluar nga OE ka te dhena teknike te pasakta sepse ajo nuk mbeshtet ne te dhenat e katalogeve te paraqitur. Oferta e OE ka te dhena teknike te pasakta, te paplota, pa referenca dhe te pambeshtetura ne kataloget e prodhuesit.

Argumentimi jone per sa me lart pretendohet nga KVO

Pas ankeses tone, lidhur me kete pike, KVO vazhdon me te njejtin arsyetim duke pretenduar se "OE nuk shprehet qarte per modelin qe oferton pasi referuar dokumentacionit te paraqitur rezulton se seria Aquilon Lightning ofron modelin TSX 035A (16 Slice) dhe TSX-036X (80Slice). Gjithashtu KVO shton te pergjigja e tyre se ka konstatuar keto parregullsi per shkak te lapsuseve te vete OE ankimes dhe eshte ne tagrin e KVO te vleresojë rast mbas rasti mbi nevojën per sqarime nga OE pjesemarrës.

Sic duket qarte me siper cituar, jo vetem nga "pretendimi" i tyre qe ka cuar ne skualifikim por edhe nga pergjigja e kthyer vihet re qartazi se KVO eshte treguar krejtësisht siperfaqesore ne interpretimin e dokumentacionit të paraqitur, pa u futur ne detaje. "Rezulton" që KVO ka qene konfuze per te konkluduar se cili model pajisje ishte ofertuar por ne te njejten kohe as nuk ka dashur te sqarohet me OE mbi kete ceshtje dhe sic edhe shprehet se pergjigjen e kthyer se "eshte ne tagrin e KVO te vleresojë mbi nevojën per sqarime nga OE". KVO kerkon te justifikohet se as nuk ka dashur fare te sqarohet pasi dihej se po te sqarohet do rezultonte se pajisja me 80 slice e ofertuar nga ne nuk mund te skualifikohej dhe per pasoje ka vendosur te nxitoje me skualifikimin tone ne menyre qe ti hapi rrugen operatorit te renditur i katerti ne liste, por i paracaktuar si fitues, Montal SHPK.

Dua te shtoj ketu se ligjvënës ne LPP, neni 53, "Shqyrtimi i Ofertave "<pika 1 e tij} parashikon: Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kerkon ofertuesve sqarime per ofertat e tyre, per shqyrtimin, vleresimin dhe krahasimin sa më të drejtë të ketyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara ne nenet 32 dhe 33 te ketij ligji, nuk duhet te kerkohet, ofrohet apo lejohet asnje ndryshim ne permbajtjen e ofertes, perfshire ndryshimet ne cmim apo ndryshime qe synojne te kthejne nje oferte te pavlefshme ne te vlefshme" nuk e ka parashikuar kete dispozite per te qene e zbatueshme ne varesi te deshires se KVO por eshte detyrim per ta zbatuar KVO sa here qe e shikon te arsyeshme. Ne rastin konkret qe KVO nuk ka "kuptuar", sic e pranon qartesisht vete, nese eshte ofertuar nje pajisje me 16 slice qe kerkohej realisht apo eshte ofruar nje pajisje me e mire 80 slice, ka qene fiks momenti dhe e detyruar per ta sqaruar me operatorin ekonomik dhe jo te vazhdonte me skualifikimin e tij direkt. Per sa i perket pretendimeve te KVO-se lidhur me dokumentacionin e paraqitur per Skaner 16 Slice, KVO nuk eshte treguar aspak e kujdesshme ne menyren se si i kane shprehur pretendimet pasi shpesh here ato jane kontradiktore si dhe te pa bazuara se pari ne kerkesat e vete AK ne DST dhe se dyti te pa bazuara ne frymen e legjislacioni te prokurimit publik.

Ashtu sic edhe vete KVO referon, shoqeria jone ka ofruar, modelin Aquilon Lightning to prodhuesit japonez Canon por pak me vone, ne te njejten shkrese, shprehej se KVO konstatoi se OE nuk ka deklaruar mode/in e skanerit qe ka ofruar eshte krejtësisht kontradiktor dhe i pabazuar. Ne kriteret e vecanta per kualifikim dhe ne shtojcën 10, AK percaktuar nje seri kriteresh lidhur me kete pajisje te cilat poi rendisim me poshte:

Specifikimet teknike;

-Kerkesen per kataloge teknike per artikujt e ofertuar ku te jene te pasqyruara specifikimet teknike te kerkuara per keto artikuj. Ne kataloge, duhet te shenohet sipas numrit te artikullit ne Formularin

e Ofertes dhe te markohen me ngjyre te ndezur (te verdhe), artikulli i ofruar bashke me specifikimet teknike. (Kataloget duhet te ngarkohen ne ëëë.app.gov.al se bashku me dokumentacionin e kerkuar ne keto DT. Pershkrimi teknik duhet te jete i perkthyer ne gjuhen shqipe ne pjeset qe kane lidhje me specifikimet teknike te kerkuara ne DST).

-Kerkesen per paraqitjen e Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktives (MDD ose MDR) 93/42 EEC, te vlefshme, ose ekuivalent, per artikujt e ofruar, sipas kategorizimit te tyre.

Ne plotesimin e ketyre kerkesave, per pajisjen Skaner 16 Slice te kerkuar, ne kemi ofruar pajisjen Skaner 80 Slice Aguilon Lightning TSX-036A/7. Sipas kerkeses se AK, ne kemi paraqitur katalogun e pajisjes i cili eshte i perkthyer, i noterizuar dhe markuar rregullisht sipas kerkeses se AK i cili gjendet ne materialin e emertuar Aquilon Lightning 16 Slice- Compressed duke filluar nga fq 108 deri ne 143.

Pra pretendimi i KVO se ne dokumentacioni e paraqitur nga OE rezultojne mungesa, parregullsi dhe mosperputhje, nuk qendron.

Per sa i perket Markimit te Broshures me disa te dhena te pergjithshme per modelin TSX-035A, qe AK pretendon, sqarojme se prodhuesi ka bere kete brochure per aksesoret ku perfshin te dyja modelet, 16 dhe 80 slice pra edhe TSX 035a 16 slice edhe TSX036 A 80 Slice dhe i gjithë markimit eshte ne perputhje me specifikimet teknike qe i referohen modelit TSX 036A pra per ate 80 Slice. Ne te gjithë kete katalog jane markuar specifikimet teknike qe i referohen modelit TSX 036A.

Specialistet e KVO duhet ta kishin kuptuar qe ne kemi ofertuar skaner 80 slice ne vend te atij me 16 slice pra, edhe se cilin model jane markuar specifikimet teknike.

Vijme perseri aty ku del ne pah Neni 53 I LPP, "Shqyrtimi i Ofertave" pika I e tij parashikon: Autoriteti kontraktor, kur e shikon te arsyeshme, u kerkon ofertuesve sqarime per ofertat e tyre, per shqyrtimin, vleresimin dhe krahasimin sa më të drejte të ketyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara ne nenet 32 dhe 33 te ketij ligji, nuk duhet te kerkohet, ofrohet apo lejohet asnje ndryshim ne permbajtjen e ofertes, perfshire ndryshimet ne cmim apo ndryshime qe synojne te kthejne nje oferte te pavlefshme ne te vlefshme.

Kuptohet, KVO ishte krejtesisht e qarte mbi modelin e ofertuar i cili ishte TSX 036A (80) Slice dhe normalisht nuk do te merrte guximin te zbatonte ligjin ne kete rast duke bere kerkesa per sqarim pasi dihej qe nuk do te mundej te vazhdonte me skualifikimin. Per kete arsye e kaperceu kete hap duke na skualifikuar ne menyre qe te arrije te "objektivi" Montal SHPK. Pikerisht, qe ne kemi ofertuar katalogun 80 slice e verteton edhe perkthimi ne gjuhen shqip qe i eshte bere edhe katalogut.

Ai eshte perkthyer, noterizuar, markuar ne perputhje te plote me kriterin kualifikues parashikuar ne DST, ne gjithashtu kemi paraqitur vete katalogun teknik ku pasqyrohen te gjitha specifikimet e pajisjes 80 Slice qe kemi ofertuar duke ju referuar modelit TSX 036A

Kjo eshte nje prove e pakundershtueshme dhe KVO ne rast te mos kuptimit duhet te kishte kerkuar shpjegim.

Pra perfundimisht konkludojme se nuk ka patur vend qe KVO te behej "konfuze" mbi modelin e ofruar pasi te gjithë dokumentet teknike duke perfshire, katalogun e pajisjes te markuar sic kerkohej ishte e qarte se BNT ka ofertuar pajisjen TSX 036A me 80 slice ne vend te asaj te kerkuar me 16 Slice.

Gjithashtu sic edhe permendem me lart, ligjvenesit ka parashikuar edhe raste te tilla prandaj ka cituar ne nenin neni 53, "Shqyrtimi i Ofertave" pika I e tij parashikon: Autoriteti kontraktor, kur e shikon te arsyeshme, u kerkon ofertuesve sqarime per ofertat e tyre, per shqyrtimin, vleresimin

dhe krahasimin sa me te drejte te ketyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara ne nenet 32 dhe 33 te ketij ligji, nuk duhet te kerkohet, ofrohet apo lejohet asnje ndryshim ne permbajtjen e ofertes, perfshire ndryshimet ne cmim apo ndryshime qe synojne te kthejne nje oferte te pavlefshme ne te vlefshme.

Referuar dispozites se sipercituar nese AK do donte te kryente nje vleresim sa me te drejte te ofertave dhe nese eshte ndjere vertet konfuzo dhe nuk ka dalluar model in e pajisjes se ofruar atehere mund te shfrytezonte kete mundesi te detyrueshme qe ligjvenesit i ka vendosur ne dispozicion duke na kerkuar sqarimet perkatese dhe jo te tejkalonte kete hap kaq te rendesishem duke na skualifikuar.

KVO jo vetem se e tejkalon kete hap kaq te rendesishem por ka kaluar te ofertuesit i renditur pas BNT me nje oferte prej afersisht 14.000.000 leke me te shtrenjte. Ky veprim bie ndesh dhe shume rende me vete qellimin e ligjit qe i cili eshte te miremenxhoje fondet publike dhe buxhetin e shtetit. Per sa i perket pretendimit te KVO-se mbi numrin e shprehur jo sakte te rreshtave te detektorit, sic eshte vene re edhe nga KVO por mund ta vini re dhe ju, ne kemi ofruar nje sistem shume me te mire sesa ai qe kerkohej ne dst;

Per sa i perket numrit te rreshtave te detektorit KVO duhej ti referohej katalogut ku sic referon edhe vete KVO, ne katalog numri i rreshtave te detektorit eshte 80. Eshte me rendesi qe katalogu i markuar i cili eshte dokument qe eshte kerkuar nga AK dhe mbi te cilin do te kryhet vleresimi i ofertes eshte konform ne perputhje me specifikimet e kerkuara.

Shtojme ketu se LPP, Neni 53, pika 3 parashikon: Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit". Ne rastin konkret Oferta teknike e paraqitur nga ne eshte nje dokument ekstra, nuk eshte kerkuar ne Dst.

Per sa i perket pretendimit per CE e paraqitur per modelin TSX 035A, kjo CE eshte hedhur gabimisht ne vend te CE per modelin TSX036A. Per pasoje ky eshte nje dokument teper i paraqitur ne tender i cili nuk mund te merret ne shqyrtim per ta vleresuar pasi neve nuk kemi ofertuar ate model, nuk kemi paraqitur as oferte teknike apo katalog per ate model ashtu sic edhe KVO ka deklaruar ne pretendimet per skualifikim. Per pasoje nje dokument i paraqitur me teper dhe qe ska lidhje me objektin e tenderit nuk kemi pse te merremi me shtjellimin e ceshtjes. AK nuk mund te vleresoje dhe te skualifikoje per nje dokument qe eshte paraqitur teper ne SPE pasi AK duhet te beje vleresimin vetem per kriteret e kerkuara ne DST.

Nderkohe lidhur me pretendimin e AK-se se OE nuk ka paraqitur certificate CE te konformitetit per CT model TSX-036/A sic kerkohet ne DST ju bejme me dije se KVO ka marre dijeni qe kjo pajisje eshte konform direktivave te Keshillit Evropian qe duhet te jete ne perputhje me to. Kjo, jo vetem se as nuk diskutohet perpuethshmeria e cilesise nga prodhuesi Japonez Canon por mbi te gjitha kete informacion e kane gjetur edhe ne katalogun e pajisjes i cili eshte i markuar me te "verdhe" ku shpreh qartazi se kjo pajisje eshte ne perputhje me direktivat e Keshillit European dhe amendimet vijuese:

IEC 60601-2-44:2009+Amd. 1: 2012+Amd 2. 2016

IEC 60601-1: 2005 + Amd 1: 2012

IEC 60601-1-2:2014

IEC 60601-1-3: 2008+ Amd 1. 2013

IEC 60601 -1 -6: 2010+ Amd 1.: 2013

IEC 60601-2:28:2010

IEC 60825-1 :2007

IEC62366:2007+Amd:2014

IEC 62304:2006+Amd.1: 2015

(shiko katalogun e markuar dhe te uploaduar ne sistem)

Pervec se si me larte KVO ka marre dijeni qe pajisja eshte ne perputhje te plote me direktivat evropiane. Gjate ankimit tone AK ne kemi bashkengjitur edhe dokumentin CE per pajisjen model TSX 036A te perkthyer dhe noterizuar sipas kerkeses tuaj. Ky eshte nje dokument qe ekziston ne historikun e shoqerise sone pra eshte si dokument dhe nuk eshte marre pas hapjes se tenderit pasi ne e dispononim kete dokument.

Ne botimit e SIGMA-OECD "Vendime gjyqesore te perzgjedhura te Gjykates se Drejtesise se BE per prokurimin publik (2006-2014)", lexojme se ne Ceshtjen C-336/12 Manova, "GjD-ja arriti ne perfundimin se autoriteti kontraktues mund te kerkonte ndreqjen ose amplifikimin e detajeve te aplikimit mbeshtetur ne nje arsye te kufizuar dhe te vecante. Ky amendament lejohet per aq kohe sa kerkesa ka te beje me detaje ose informacione qe tregojne objektivisht se i perkasin periudhes para dates se skadimit te afatit te fundit per dorezimin e aplikimeve (paragrafi 39). GjD-ja gjithashtu theksoi nje kusht thelbesor: kerkesa per informacionin qe mungon nuk duhet te favorizojte padrejtesisht apo t'i krijojte disavantazhe kandidatit ne fjale (paragrafi 42). GjD-ja i zbatoi keto kushte ndaj fakteve ne Ceshtjen C-336/12 Manova. Ajo konfirmoi se bilancet ekzistonin tashme dhe ishin publikuar para paraqitjes se aplikimit. Ajo arriti ne perfundimin se me pranimin e kopjeve te bilanceve pas dates se aplikimit autoriteti kontraktues nuk kishte shkelur parimin e trajtimit te barabarte".

Ne kuptim te nenit 116 te Kushtetutes dhe "Marreveshjes se Stabilizim Asociimit Ndermjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve te Tyre Anetare Dhe Republikes Se Shqiperise", neni 70 i se ciles parashikon se: "Palet njohin rendesine e perafimit te legjislacionit ekzistues shqiptar me ate te Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqiperia do te perpiqet te siguroje qe ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshern te shkoje gradualisht drejt perputhjes me acquis e Komunitetit. Shqiperia do te siguroje qe legjislacioni ekzistues dhe i ardhshem te zbatohet dhe imponohet si duhet", Komisioni i Prokurimit Publik i referohet jurisprudences se Gjykates se Drejtesise se BE ne vendimmarrjen e tij.

Lidhur me trajtimin e ceshtjeve te nje natyre te tille, ju lutem referojuni dhe vete vendimeve te K.P.P.613/2014 dhe K.P.P.664/2016 te Komisionit te Prokurimit Publik si institucioni me i larte administrativ ne fushen e prokurimeve publike ku ky i fundit ka pranuar ankesat e operatoreve ekonomik.

Per sa i perket pretendimit te KVO lidhur me trupin certifikues te CE-se ju rikujtojme se kriteri kualifikues parashikuar ne dst ishte: Operatori Ekonomik paraqitjen e Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktives (MDD ose MDR) 93/42 EEC. te vlefshme. ose ekuivalent per artikujt e ofruar, sipas kategorizimit te tyre. Sic verehet qartazi, ne asnje rast kerkesa nuk shpreh se se Certifikata duhet te te jete e leshuar nga nje trup certifikues, thjesht kerkon te jete ne perputhje me direktivat MDD ose MDR 93/42 EEC. Ne kuptimin e kesaj kerkese, CE qe ne po Bashkengjisim eshte ne perputhje te plote me kerkesat e AK ne DST. Gjithashtu ne kriteret e DST eshte vene edhe opsioni "ose e vlefshme" duke lene te hapur cdo opsion dhe e vlefshme me certifikaten e konformitetit CE mund te konsiderohet edhe vete katalogu qe sic thame me lart ne pjesen me te verdhe" ku shpreh qartazi se kjo pajisje eshte ne perputhje me direktivat e Keshillit Evropian dhe amendimet vijuese:

IEC 60601-2-44:2009+Amd. 1: 2012+Amd 2. 2016

IEC 60601-1: 2005 + Amd 1: 2012.....

Per sa kohe eshte lene fjala "ose" ekuivalente, kjo nenkupton cdo dokument qe shpreh parametra te tille keshtu qe edhe vete katalogu eshte nje dokument qe i shpreh shume qarte te gjitha keto te dhena te kerkuara nga AK cka ben qe ne te plotesojme kete kriter.

Per pasoje Ak nuk mund te na skualifikoje per kete arsye pasi Ligji i Prokurimit Publik, neni 53 "Shqyrtimi i Ofertave" pika 3 parashikon: Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetern nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij ligji. Ne rastin konkret CE e bashkengjitur eshte ne perputhje te plote me kerkesat e specifikuar ne njoftimin e kontrates dhe me DST.

Kriteret per kualifikim vendosen qe t' i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushjen me sukses te kontrates dhe se Autoriteti kontraktor nuk duhet te gjykoje ne menyre siperfaqesore e formale, por te analizoje ne themel dhe ne menyre te arsyeshme e proporcionale kapacitetet e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatet, ne funksion te qellimit dhe rrethanave faktike per te cilin vendosen kriteret e percaktuara dhe vecanerisht nuk duhet te shikojne ne menyre siperfaqesore dokumentat qe leshohen nga vete autoriteti kontraktor.

Duam te shtojme edhe dicka tjeter. Duke qene se specifikimet teknike ishin hartuar ne menyre te tille qe vetem nje produkt i plotesonte, perkatesisht GE ofruar nga Montal SHPK e bente te pamundur te futeshim me nje pajisje 16 Slice pasi do rezultonte se ndonje specifikim nuk do te permbushej nga pajisja jone 16 slice ashtu sic kane rezultuar edhe ofertat e operatoreve te tjere pjesemarres. Ne jemi detyruar te ofrojme pajisje 80 slice ne vend te asaj 16 te kerkuar. Si perfundim, nje paqartesi e KVO mbi modelin e pajisjes nuk duhej te conte ne skualifikim. KVO duhet te kishit ndjekur rrugen ligjore per t'u qartesuar duke na drejtuar nje kerkese per sqarim ashtu sic parashikon ligji dhe jo te kapercenit kete hap kaq te rendesishem duke nxituar me qellim kualifikim e ofertes se paraqitur nga operatori i "preferuar" madje dhe me nje diferenceme te larte prej afersisht 14.000.000 leke me shtrenjte duke i shkaktuar dem buxhetit te shtetit. Ne nje kohe, kur ju do te merrnit nje pajisje 80 Slice me vleren e asaj 16 Slice.

Pra perfundimisht konkludojme se te gjitha dokumentet Teknike qe kerkohen ne dst nga AK dhe te paraqitura nga ne, i referohen pajisjes Scanner 80 Slice e cila eshte shume here me larte teknikisht se ajo 16 Slice e kerkuar. Nuk ka patur vend per KVO qe te ishte e paqarte por thjeshte ka perdorur keto artifica per te na skualifikuar ne dhe per te kualifikuar operatorin e renditur pas nesh. Pra asnje nga pretendimet e KVO-se nuk qendron per kete pike.

Per Skanerin 64 Slice, KVO ka pretenduar:

1. Dokumentacioni i paraqitur rezulton jo i plote dhe nuk eshte ne perputhje me kerkesat e percaktuar ne DST. Per CT skaner 64 slice Operatori nuk ka paraqitur certificate CE sic kerkohet ne DST. OE ka paraqitur deklarim konformiteti CE leshuar nga firma prodhuese CANON per modelin Aquilion Prime SP, por nuk ka paraqitur certificate CE per kete produkt leshuar nga trupe certifikuese.

2. Oferta Teknike ka te dhena teknike te pasakta, te paplota, pa referenca dhe te pambeshtetura ne kataloget e prodhuesit. Oferta teknike nuk permban pershkrime te detajuara sikurse kerkohet, madje nuk deklarohen as emertimet e produkteve/softuerëve dhe as referencat perkatese ne

katalog apo dokumente te prodhuesit. Nga vleresimi i ofertes teknike rezulton se oferta e ofertuar nuk ploteson gjithashtu specifikimet teknike te percaktuara ne specifikimet teknike.

- Ne Dst eshte kerkuar: Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlere ekuivalente, me permiresim nga softueri), 30 MHU Ne oferten teknike to ketij OE, ky specifikim eshte ofruar: Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlere ekuivalente, me permiresim nga softueri), 14 MHU

- Ne DST eshte kerkuar: Minimizimi i zhurmes, krahasuar me teknika standarde, deri ne Jo me pak se 90%. NE oferten teknike te ketij OE, ky specifikim eshte ofruar: Minimizimi i zhurmes, krahasuar me teknika standarde, deri në jo me pak se 50%.

3. Ne DST eshte kerkuar: Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar per - Programet kryesore te Konsolit Teknike per optimizim te vleres se mA dhe rregullim te dozes sipas anatomise se pacientit me ane te modulimit te rrymes ne tubin me rreze-x Teknike per uljen e dozes ne femije Teknike per studime angiografike te CT me detektim te bolusit automatik Teknike per reduktim te artifakteve te shkaktuara nga prania e metaleve ne trupin e pacientit Teknike per reduktim te zhurmave Rindertim shumeplanesh ne kohe reale Rindertim 3D - Program i specializuar per: - vleresimin sasior te patologjive pulmonare, - segmentimin automatik te mushkerive, - gjurnim volumetrik te rrugeve te frymemarjes, - identifikim i perfuzionit lidhur me Embolizmen Pulmonare, Obstuksione Kronike Pulmonare, Emfizeme Pulmonare, etj.

Ne oferten teknike te ketij OE, nuk jane perfshire pershkrime te detajuara per permbushjen e te gjitha specifikimet teknike qe kerkohen. Ne oferten teknike nuk deklarohen, nuk pershkruhen dhe nuk jepen referenca me katalogun apo dokumente te tjera te prodhuesit. Modeli i ofruar ka edhe nje devijim te cilen KVO e konsideron te vogel: NE Dst eshte kerkuar: Rezolucioni hapësinor, ne shpejtesine maksimale te rrotullimit (FOV=50cm) 5 0.30 mm NE oferten teknike to ketij OE, ky specifikim eshte ofruar: Rezolucioni hapësinor, ne shpejtesine maksimale te rrotullimit (FOV=50cm) 0.31 mm.

Dokumentacioni i paraqitur per plotesimin e kriterëve te vecanta per kualifikim (KVK) rezulton Jo i plote dhe nuk eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat e percaktuara ne DST, konkretisht me Kreun, seksioni i te dokumenteve te tenderit "Udhëzime per operatorët ekonomike" ku percaktohet se: "Operatorët Ekonomike jane te detyruar te pergatisin oferta, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne keto DT Ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto DT do te refuzohen si te papranueshme".

Lidhur me kete pike ju sqarojme se pas ankeses tone AK ka pranuar ne ceshtje pretendimet tona pasi ne pergjigjen e kthyer AK ka hequr dore nga pretendimet fillestare dhe trajton vetem dy pika te cilat jane:

Kapaciteti Ngrohes i Anodes

Minimizimi i Zhurmes

Gjithsesi po ju permbledhim me poshte argumentimin tone edhe per pretendimet fillestare dhe me pas pretendimet perfundimtare te AK.

Per sa i perket pretendimit te KVO lidhur me Ce, nuk qendron. Kjo per arsye se ne kemi paraqitur Ce e ketij produkti ne Filin e emertuar "Dokumente Ligjor 7" per modelin TSX- 303 B (Aguillon Prime SP). Ky dokument eshte i perkthyer, noterizuar ne perputhje te plote me kerkesen tuaj.

Per sa i perket pretendimit tuaj lidhur me trupin certifikues te CE-se ju rikujtojme se kriteri kualifikues parashikuar ne dst ishte: Operatori Ekonomik te paraqese Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktives (MDD ose MDR) 93/42 EEC, te vlefshme, ose ekuivalent, per artikujt e ofruar, sipas kategorizimit te tyre. Sic verehet qartazi, ne asnje rast kerkesa nuk shpreh se

Certifikata duhet te jete e Ieshuar nga nje trup certifikues, thjeshte kerkon te jete ne perputhje me direktivat MDD ose MDR 93/42 EEC. Ne kuptimin e kesaj kerkese, CE e paraqitur eshte ne perputhje te plote me kerkesat e AK ne DST. Gjithsesi sic duket, AK sic duket e ka pranuar ne heshtje kete pike pasi ne pergjigjen e kthyer per ankesen tone nuk e trajton me si nje nga pikat skualifikuese. Shtojme ketu, se AK pranon ankesen tone per kete pike ne heshtje pa e prekur fare nderkohe per Scannerin 16 Slice qe ne kemi ofruar 80 Slice vazhdon ta referoje si pike skualifikuese. Duket qarte kontradiktioriteti i KVO.

Per pasoje Ak nuk ka vazhduar ta referoje si pike skualifikuese kete "arsye" pasi Ligji i Prokurimit Publik, neni 53 "Shqyrtimi I Ofertave" pika 3 parashikon: Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij ligji. Ne rastin konktret CE e bashkengjitur eshte ne perputhje te plote me kerkesat e specifikuara ne njoftimin e kontrates dhe me DST.

Lidhur me oferten teknike, ky eshte nje dokument i paraqitur ekstra nga neve jo se ishte kriter kualifikues sipas DST. Edhe kete pike nuk e trajton me AK si ceshtje skualifikimi por e pranon ne heshtje ne pergjigjen e kthyer. Perseri kontradiktore me vendimin e saj pasi per skanerin 16 slice te kerkuar qe ne kemi ofertuar 80 slice vazhdon te vleresoje oferten tone mbi nje dokument te pakerkuar nga AK. Sic thame edhe me lart AK nuk mund te beje vleresim dhe skualifikim mbi kriteret qe nuk jane kerkuar ne DST.

Lidhur me pretendimin e KVO per pershkrimin e detajuar te specifikimeve, sqarojme se ankesa jone eshte pranuar ne heshtje nga KVO pasi sic permenda edhe me larte nuk e trajton me si pike skualifikuese ne pergjigjen e kthyer. Gjithsesi po ju sqarojme edhe juve si me poshte:

Per te gjitha softet dhe teknikat perkatese kemi paraqitur te markuar me te verdhe te gjitha funksionet qe i perkasin kerkesave te paraqitura ne tender.

- Programet kryesore te Konsolit Teknike per optimizim te vleres se mA dhe rregullim te dozesh sipas anatomise se pacientit me ane te modulimit e rrymes ne tubin me rreze-x SUREExposure & SUREkV

- Teknike per reduktim te artefakteve te shkaktuara nga prania e metaleve ne trupin e pacientit - Single Energy Metal Artifact Reduction (SEMAR)

- Teknike per reduktim te zhurmave - Pure Vision

- Rindertim shumeplanesh ne kohe reale - MPR

- Rindertim 3D ne faqen 7 te katalogut me specifikime teknike shprehet: 3D color image processing (surface rendering, volume rendering, MPR, curved MPR, MIP, cine)

- Program i specializuar per: - vleresimin sasior te patologjive pulmonare, - segmentimin automatik te mushkerive, - gjurmim volumetrik te rrugeve te frymemarjes, - identifikim i perfuzionit lidhur me Embolizmen Pulmonare, Obstuksione Kronike Pulmonare, Emfizeme Pulmonare Vitrea CT Lung Package Lung volume analysis (CSLV-001A)

Lidhur me specifikimin Teknik te cilin KVO e ka konsideruar devijim te vogel, fakti qe edhe AK e quan devijim do te thote se nuk ka ndikim ne performancen e produktit apo funksionalitetin e tij. Edhe vete neni 53 i LPP percakton dhe lejon devijime te vogla qe nuk ndryshojne thelbesisht karakteristikat kushte dhe kerkesat e percaktuara ne dokumentet e tenderit. Vete LPP, neni 53, pika 4 shprehet se: Autoriteti kontraktor vlereson nje oferte te vlefshme edhe nese ajo permban devijime te vogla, te argumentuara, te cilat nuk ndryshojne thelbesisht karakteristikat, kushtet dhe

kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, te cilat mund te korrigojohen pa prekur permbajtjen e saj.

Perseri, konkludojme se asnje nga pretendimet tuaja nuk qendrojne dhe per pasoje nuk perbejne kusht per skualifikim.

Ne pergjigjen e kthyer nga KVO ndaj ankeses tone, rezulton te mos kete pranuar vetem dy pikat e meposhtme duke u shprehur si me poshte:

Ne dst eshte kerkuar: kapaciteti ngrohes i Anodes (vlera ekuivalente, me permiresim nga software, 2: 30 MHU. Ne oferten teknike te ketij OE, ky specifikim eshte ofruar 14 MHU.

Ne dst eshte kerkuar: Minimizimi i Zhurmes krahasuar me teknika standarde deri ne jo me pak se $\geq 90\%$. Ne oferten teknike te ketij OE eshte ofruar: Minimizimi i Zhurmes krahasuar me teknika standarde deri ne jo me pak se 50% . Gjithashtu KVO shton se vete OE e ka pranuar mosplotesimin e ketyre pikave. Deklarate kjo e pavertete nga KVO.

Per sa i perket Kapacitetit të nxehtesise maksimal të llambës, habitemi me pretendimin absurd te KVO se pasi dihet se ne ditet e sotme perdoren skanera me kapacitet nxehtesie te ndryshme ne varesi te teknologjise te perdorur.

Per sa me siper, ne u ankuam ne KPP qysh perpara se te mernim pjese ne tender. Ne e shpjeguem me detaje teknologjinë qe perdor Canon. Ne, gjithsesi e plotesonim kapacitetin ngrohes te anodes por e kishim me te vogel ate me "permiresim me softuerë" ndaj une ne takimin me organizuar nga Ju me specialistet e Ministrise se Shendetsise e shpjegova me skema te sakta dhe te kuptueshme edhe per nivelin jo te larte teknik qe te behej e kuptueshme per secilin pjesëmarrës ne takim. Cdo gje u kuptua aq sa edhe punonjesja juaj kerkoj qe ne te mos e plotesonim me detaje dokumentin perfundimtar pasi, sic ajo u shpreh, "ju e shpjeguat aq mire sa u kuptua qarte nga secili prej nesh". Pra, Skaneri i ofruar nga ne ka kapacitet ngrohes te anodes me permiresim me softuerë prej 14 MHU dhe gjithashtu nje cooling rate shume me te mire nga sa eshte kerkuar, qe tregon nje teknologji qe shume firma konkurrentë nuk e kane. Pra, ky eshte nje avantazh i Canon dhe jo disaavantazh sic pretendon KVO. Per me teper, nese GE ka nje parameter me te dobet nuk duhet te sjelle ne skualifikim te firmave pjesëmarrëse qe kane teknologji me te mire per kete parameter. Reduktimi i nxehtesise ne anode ndikon ne rritjen e jetegjatesise se llampes se rrezeve X. Pra ky eshte nje benefit per pajisjen dhe institucionin qe prokuron.

Pra, edhe njehere sjellim ne vemendjen tuaj, se gjate takimit qe patem me ju si KPP, ceshtja e MHU-se ka qene pika kryesore qe kemi trajtuar per Skanerët. Dhe gjate ketij takimi, une ju kam bere nje shpjegim te detajuar te teknologjise se Canon per kapacitetin ngrohes te anodes duke e ilustruar edhe me shembuj (ju kemi lene edhe materialet qe u perdor per ilustrim) dhe madje kjo u kuptua nga te gjithë anetaret si nga Ju te KPP ashtu edhe nga perfaqesuesit e AK.

Pra pretendimi i KVO nuk qendron.

Lidhur me minimizimin e zhurmes: Ne oferten teknike kemi shprehur: Minimizimi i zhurmes krahasuar me teknika standarde $> 90\%$. Gjithashtu edhe dokumenti teknik permban keto te dhena. Gjithsesi po ju bashkengjisim nje kopje te Ofertes Teknike qe ne kemi paraqitur ne tender ku do te vereni se ne asnje moment nuk eshte deklaruar nga ne Minimizimi i Zhurmes krahasuar me teknika standarde deri ne jo me pak se 50% . Perkundrazi eshte deklaruar me e madhe se 90% . Mendojme se kjo pike eshte vendosur gabimisht ne skualifikimin tone, mbase e kishte per ndonje operator tjetër.

Pra sic rezulton, ne asnje moment, asnje nga pretendimet e AK nuk qëndrojnë.

Perfundimisht konkludojme:

- 1. Ne kemi ofruar pajisje me 80 Slice ne vend te asaj 16 Slice te kerkuar si dhe pajisje tjeter me 80 Slice ne vend te asaj 64 Slice te kerkuar.*
- 2. Absolutisht keto pajisje jane ne nje nivel Teknik shume here me te larte nga se eshte kerkuar, kjo e dokumentuar dhe e provuar me dokumentacionin Teknik te aploduar ne SPE te cilin KVO e ka verifikuar dhe ju gjithashtu mund ta verifikoni nga dokumentet bashkengjitur.*
- 3. Ajo cfare eshte edhe me e rendesishme, eshte fakti se te dyja keto pajisje te nje niveli teper te larte Teknik, dhe MSH do te prokuroje me cmimin e ofertuar ne oferte i ishte referuar fondit qe ju keni parashikuar per Skanera te nje niveli shume here me te ulet Teknik te cilet jane kerkuar ne tender.*
- 4. Akoma edhe me i rendesishem eshte fakti se se nuk mund te skualifikohet nje oferte e cila eshte ne perputhje te plote me kerkesat ligjore dhe ne perputhje te plote me kerkesat teknike madje ne kete rast shume shkalle me larte nga se eshte kerkuar me qellim qe KVO te kualifikoje nje operator tjeter me nje pajisje me nivel me te ulet Teknik se sa ate qe ne kemi ofruar dhe me nje cmim afersisht 14.000.000 leke me te shtrenjte se sa oferta jone.*
- 5. Ky hap i ndermarre nga KVO, eshte i pajustificueshem, ne shkelje te plote te vete qellimit te ligjit qe ka per qellim te mire menaxhoje fondet publike dhe ne te njejten kohe te prokuroje pajisjen e kerkuar apo dhe ne nivel me te larte se sa eshte kerkuar.*
- 6. Keto veprime kane ardhur si pasoje e shkakut kryesore qe eshte parapercaktimi i fituesit, ne kete rast Montal SHPK. Tenderi ishte bere per ate shoqeri, kete e kemi bere te ditur edhe gjate ankimeve tona dhe te operatoreve te tjere ne KPP per kete procedure si dhe gjate takimit qe ju organizuar me Ne per kete procedure ku ju kemi lene edhe broshurë te modelit GE per te cilin ishte bere tenderi.*

II.6. Nëpërmjet shkresës nr. 3403/44 prot., datë 10.11.2020, protokolluar me tonën në datën 12.11.2020 me objekt: “Dërgohet informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

II.7. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, me shkresën nr.1397/5 prot datë 24.12.2020 me lëndë “Kërkesë për asistencë”, si dhe shkresën nr. 1397/6 prot., datë 08.01.2021 me lëndë “Kërkesë e përsëritur për asistencë”, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua institucionit të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, për asistencën e një eksperti/konsulenti në fushën e pajisjeve mjekësore, që të asistonte pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me qëllim gjykimin sa më të drejtë të ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 882 prot., datë 10.02.2021, protokolluar me tonën në datën 12.02.2021 me objekt: “Kthim përgjigje”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, kthim përgjigje nga ana e institucionit të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i cili informon se “Referuar kërkesës tuaj për një ekspert/konsulent në fushën e pajisjeve mjekësore ju bëjmë me dije se AKSHI e ka të pamundur vënien në dispozicionin tuaj të një përfaqësuesi nisur nga situata e pandemisë ku një pjesë e punonjësve punojnë në distancë dhe pjesa tjetër është e orientuar në implementimin e shërbimeve online dhe në mbarëvajtjen e zbatimit të kontratave të lidhura rishtazi për implementimin e sistemeve me ndikim në masë të gjerë qytetarësh dhe biznesesh”..

II.9. Në datën 19.02.2021 me shkresën nr.1397/8 prot., Komisioni i Prokurimit Publik, iu drejtua Universitetit Politeknik të Tiranës, duke kërkuar informacion si më poshtë: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga një operator ekonomik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës konstatojmë se nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë, në përmbushje të kriterëve kualifikuese, ku përveç të tjerave, janë ngritur pretendime edhe në lidhje me specifikimet teknike për pajisje mjekësore dhe kryesisht me faktin e plotësimit/mosplotësimit të specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, si dhe verifikimin e katalogëve të paraqitur për këto pajisjet

1. Pajisje Mjeksore CT Scanner.

2. Pajisje Mjeksore Mamografi.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 19/1 e vijues të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neneve 80,81 dhe 86 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 24 pika 2 të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si edhe Vendimit Nr.867 datë 10.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, kërkojmë nga ana juaj informacion nëse institucioni juaj ka Inxhinier/Ekspert të profilizuar ose jo për pajisje mjekësore për të kryer vlerësimin teknikisht të këtyre pajisjeve nëse katalogët e paraqitur nga operatorët ekonomik janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit nëse po mund të na vini në dispozicion një Inxhinier/Ekspert për vlerësimin e sipërcituar. Gjithashtu në rast të një përgjigje pozitive, kërkojmë nga ana juaj të na informoni mbi koston apo tarifat, të cilat do të mbulohen nga ankimuesi

II.10. Me shkresën nr. 300/3 prot datë 02.03.2021, me lëndë “Kthim përgjigje”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr.1397/9 datë 04.03.2021, Universiteti Politeknik i Tiranës bën me dije se:

“Në përgjigje të kërkesës tuaj Nr.1397/7 Prot., datë 19.02.2021 ku kërkohet informacion nëse institucioni ynë ka inxhinier/ekspert të profilizuar për pajisje mjekësore, ju bëjmë me dije se propozimi ynë është:

Z.Niko Hyka”

II.11. Në datën 23.03.2021, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik, u paraqit eksperti në Universitetin Politeknik të Tiranës, Z. Niko Hyka, i cili u njoh me specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, arsyet e skualifikimit të operatorëve ekonomikë ankimues, si dhe dokumentacioni (katalogët) të dorëzuara në sistem nga operatorët ekonomikë ankimues për procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar Procesverbalit të mbajtur në këtë takim, eksperti brenda dy ditëve, duhet të shprehej në lidhje me kryerjen e këtij shërbimi dhe koston financiare të tij.

II.12. Në datën 25.03.2021, është protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresa me nr.1397/10 prot. me objekt “Propozim kosto shërbimi”, nga eksperti Dr. Niko Hyka, Ekspert i Pajisjeve Mjekësore, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës.

II.13. Në datën 26.03.2021 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin e ndërmjetëm K.P.P. 481/2021, ku vendosi:

1. Të urdhërojë kryerjen e verifikimit të katalogëve të paraqitur nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK. dhe “BNT Electronics” SHPK., nga eksperti për pajisjet mjekësore në Universitetin Politeknik të Tiranës, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-65892-07-18-2020, me objekt “F.V Pajisje mjekësore –CT Scanner”, me fond limit 144.112.500 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 23.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Operatori ekonomik “Medfau” SHPK. të parapaguajë për llogari të ekspertit Z.Niko Hyka, të Universitetit Politeknik të Tiranës, shumën prej _____ lekë si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës të protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nr.1397/10 prot datë 25.03.2021 për verifikimin e katalogëve të dorëzuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit brenda datës 31.03.2021 ora 12:00.
3. Operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK. të parapaguajë për llogari të ekspertit Niko Hyka, të Universitetit Politeknik të Tiranës, shumën prej _____ lekë si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës të protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nr.1397/10 prot datë 25.03.2021 për verifikimin e katalogëve të dorëzuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit brenda datës 31.03.2021 ora 12:00.
4. Në datën 31.03.2021 ora 12:00 të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të autoritetit kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të operatorit ekonomik “Medfau” SHPK. dhe “BNT Electronics” SHPK. shoqëruar me autorizim të posaçëm.
5. Të njoftojë ekspertin për kryerjen e vlerësimit të dokumentacionit të mësipërm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.14. Në datën 31.03.2021 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, u mbajt Seanca Dëgjimore midis operatorëve ekonomikë ankimes, ekspertit dhe anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në mungesë, megjithëse është njoftuar me vendimin e ndërmjetëm K.P.P 481/2021 në datë 26.03.2021. Në seancën dëgjimore Komisioni drejtoi pyetjet ekspertit, me qëllim kryerjen nga ana këtij të fundit të ekspertizës teknike të posaçme, mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, me specifikimet teknike të pajisjeve të dorëzuara nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK. dhe operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK. Në procesverbalin e mbajtur gjatë kësaj seance dëgjimore midis palëve, u vendos që eksperti do të përgjigjej me shkrim brenda 7 ditëve pune nga e nesërmja e mbajtjes së kësaj seance datë 31.03.2021.

II.15. Me anë të shkresës nr. 481/2 prot., datë 02.04.2021, ekspertit z. Niko Hyka, i është dorëzuar dokumentacioni i nevojshëm për hartimin e raportit përfundimtar të vlerësimit nga ana e tij, sipas procesverbalit të mbajtur në datë 31.03.2021, në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, midis palëve të interesuara.

II.16. Në datën 12.04.2021, është protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresa me nr.481/3 prot. me objekt “Për shtyrjen e afatit të dorëzimit të vlerësimeve për përgjigjet e kërkuara në shkresat Nr. Prot 1439/10 dhe Nr.Prot 481/2, datë 02.04.2021”, ku eksperti Dr. Niko Hyka, Ekspert i Pajisjeve Mjekësore, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës njofton se:

[...] Në dokumentacionin të cilin jam duke shqyrtuar, disa dokumente janë evidentuar të skanuara/ printuara/ kompresuara me rezolucion të ulët, çka ka sjellë vështirësi dhe vonesë në kohën e vlerësimit sipas afateve të parashikuara. Për këtë arsye në mirëkuptimin tuaj dhe brenda mundësive e afateve kohore që mundëson procedura në zhvillim, kërkoj shtyrjen e afatit të dorëzimit të raporteve të vlerësimit deri në datën 15.04.2021.

II.17. Në datën 13.04.2021 Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit Nr.481/4, datë 13.04.2021, vendosi:

- 1. Të pranohet kërkesën e ekspertit në lidhje me shtyrjen e afatit, për dorëzimin nga ana e këtij të fundit të raportit përfundimtar të ekspertizës së tij, për sa i përket vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomikë “Medfau” SHPK. dhe “BNT Electronics” SHPK., në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-65892-07-18-2020, me objekt “F.V Pajisje mjekësore – CT Scanner”, me fond limit 144.112.500 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 23.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*
- 2. Të shtyjë afatin për dorëzimin e raportit përfundimtar të ekspertizës nga ana e ekspertit deri në datë 15.04.2021.*

II.18. Nëpërmjet shkresës së protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 481/6 prot., datë 15.04.2021, është depozituar pranë KPP dokumenti “Raport Vlerësimi” i ekspertit Z.Niko Hyka, në lidhje me vlerësimin e dokumentacionit të operatorëve ekonomikë “Medfau” SHPK. dhe “BNT Electronics” SHPK., referuar pyetjeve sipas procesverbalit të mbajtur midis palëve në datë 31.03.2021.

II.19. Komisioni i Prokurimit Publik, me anë të shkresës nr. 481/7 prot., datë 28.04.2021, thërriti ekspertin z. Niko Hyka në një seancë sqaruese me qëllim sqarimin e disa pyetjeve dhe paqartësive për Komisionin e Prokurimit Publik, për sa i përket disa prej çështjeve të trajtuara në raportin përfundimtar të dorëzuar nga eksperti.

II.20. Në datë 29.04.2021 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, u mbajt seanca sqaruese midis ekspertit dhe anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, gjatë të cilës Komisioni i drejtoi pyetjet ekspertit, në lidhje me paqartësitë e shfaqura gjatë shqyrtimit të raportit përfundimtar të vlerësimit të dorëzuar nga ky i fundit. Gjatë kësaj seancë u mbajt një procesverbal në lidhje me pyetjet drejtuar ekspertit.

II.21. Nëpërmjet shkresës së protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 481/8 prot., datë 04.05.2021, është depozituar pranë KPP dokumenti “Kthim përgjigje për pyetjet e ngritura në takimin e datës 29.04.2021” i ekspertit Z.Niko Hyka, ku ky i fundit është përgjigjur në lidhje me pyetjet e ngritura sipas procesverbalit të mbajtur midis ekspertit dhe anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik në datë 29.04.2021, në mjediset e KPP-së.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të ankimuesve, në zbatim të nenit 30, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, në të cilin parashikohet se “*1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përgjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre*”, nisur nga arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.1. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga specifika dhe kompleksiteti i objektit të prokurimit të procedurës objekt shqyrtimi, për verifikimin e specifikimeve teknike iu drejtua një eksperti të pavaruar, me qëllim ekspertizën teknike të posaçme, mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të pajisjeve të dorëzuara nga operatorët ekonomikë “Medfau” SHPK. dhe “BNT Electronics” SHPK.

III.1.2. Gjithashtu, KPP sqaron se, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik, ka marrë vendimin K.P.P. 349/2020, datë 28.08.2020, ku ka vendosur modifikimin e dokumenteve të tenderit, pas shqyrtimit të ankesave të dy operatorëve ekonomikë, të cilët kërkonin modifikimin e kriterëve të kualifikimit, dhe të specifikimeve teknike të procedurës objekt shqyrtimi. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, disa nga kriteret dhe specifikimet teknike për të cilat operatorët ekonomikë ankimues janë skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi për mospërbushjen e tyre, nuk kanë qenë objekt i

ankesave në lidhje me modifikimin e kriterëve, për të cilat KPP është shprehur në vendimin KPP 349/2020, datë 28.08.2020.

III.1.3. Marrë shkas nga arsyet e skualifikimit të operatorëve ekonomikë ankimues, nga verifikimi i kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilave është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, si dhe nga raporti përfundimtar i hartuar nga eksperti në lidhje me specifikimet teknike, për të cilat janë skualifikuar operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se këto kriterë janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe të gjitha standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat rregullojnë fushën objekt prokurimi.

III.1.4. Konkretisht autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, Shtojca 10 “*Specifikimet teknike*”, ka përcaktuar:

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

SCANNER CT 64 SLICES

Detektor	
<i>Fusha e pamjes se skanimit, cm</i>	$\geq 50 \text{ cm}$
<i>Gjeresia e plote e detektorit (mbulimi) ne drejtimin gjatesor (aksi-z), mm</i>	$\geq 40 \text{ mm}$
<i>Minimumi i trashesise se prerjes, mm</i>	$\leq 0.625 \text{ mm}$
<i>Koha minimale e nje rrotullimi 360°, sekonda</i>	$\leq 0.5 \text{ sec}$
<i>Numri i prerjeve per rrotullim</i>	≥ 128
<i>Numri i rreshtave fizike te detektorit</i>	≥ 64
<i>Numri total i elementeve te detektorit</i>	$\geq 54,000$
<i>Shkalla e absorbimit nga detektor</i>	$\geq 98\%$
<i>I pajisur me sistem te avancuar marrje te dhenash per permiresim maksimal te perfomances se imazhit, reduktim maksimal zhurmash dhe frekuence maksimale te kampionimit jo me pak se:</i>	$\geq 2400\text{Hz}$
Gantry	
<i>Pjerresimi (real, jo digital), grade</i>	$\pm 30^{\circ}$
<i>Diametri i dritares</i>	<i>jo me pak se 70 cm</i>
<i>Kontrrolli i levizjes se shtratit nga konsola dhe nga te dy anet e gantry-t</i>	<i>Te perfshihet</i>
<i>Pajisur me ekran per parametrat e skanimit dhe EKG</i>	<i>Te perfshihet</i>
<i>Sistemi i pozicionimit</i>	<i>Lazer</i>
Tubi i Rrezeve X	
<i>Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlere nominale, pa permiresim nga softueri), MHU</i>	$\geq 7 \text{ MHU}$
<i>Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlere ekuivalente, me permiresim nga softueri), MHU</i>	$\geq 35 \text{ MHU}$
<i>Largimi i nxehtesise se Anodes (ftohja)</i>	$\geq 1000 \text{ kHU}$
<i>Numri i pikave fokale</i>	≥ 2

<i>Fokusi i vogel</i>	$\leq 0.65 \text{ mm}^2$
<i>Fokusi i madh</i>	$\leq 1.32 \text{ mm}^2$
Gjeneratori	
<i>Fuqia, kV (vlera nominale, pa permiresim nga softueri)</i>	$\geq 48 \text{ kv}$
<i>Fuqia, kV (vlera ekuivalente, me permiresim nga softueri)</i>	$\geq 250 \text{ kv}$
<i>Diapazoni ne dispozicion, kV</i>	<i>nga ≤ 80 deri ne $\geq 140 \text{ kV}$</i>
<i>Hapat e rregullimit te tensionit</i>	≥ 4
<i>Intensiteti i rrymes (vlera nominale, pa permiresim nga softueri), mA</i>	$\geq 400 \text{ mA}$
Shtrati i Pacientit	
<i>Gjatesia e shtratit, cm</i>	$\geq 220 \text{ cm}$
<i>Gabimi ne pozicionimin gjatesor te shtratit, mm</i>	$\leq 0.2 \text{ mm} \pm 0.05 \text{ mm}$
<i>Diapazoni i Levizjes vertikale, cm</i>	<i>nga ≤ 50 deri ne $\geq 80 \text{ cm}$</i>
<i>Diapazoni i skanimit cm</i>	$\geq 170 \text{ cm}$
<i>Kapaciteti i peshes se shtratit, kg</i>	$\geq 225 \text{ kg}$
<i>Aksesore pozicionimi, mbajtjes dhe mbeshtes per pacientin</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Pozicionues i kokës për skanim në pozicionin shtrire dhe i prirur</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
Performanca	
<i>Vlera maksimale e Pitch</i>	≥ 1.5
<i>Rezolucioni hapsinor, ne shpejtesine maksimale te rrotullimit (FOV=50cm)</i>	$\leq 0.28 \text{ mm}$
<i>Rezolucioni Maksimal i Kontrastit (MTF) ne 4%</i>	$\geq 18 \text{ lp/cm}$
<i>Te kete algoritem rindertimi per minimizimin e zhurmes</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Minimizimi i zhurmes, krahasuar me teknika standarte, deri ne jo me pak se</i>	$\geq 90\%$
<i>Te kete algoritem te veçante rindertimi per minimizimin e dozes</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Minimizimi i dozes, krahasuar me teknika standarte, deri ne jo me pak se</i>	$\geq 80\%$
<i>Te kete algoritem per minimizimin e artefakteve nga metalet</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
CT Console - Kapaciteti Rindertues	
<i>Njesia e perpunimit qendror</i>	<i>CPU 2 x Intel Xeon (ose ekuivalent), RAM $\geq 32 \text{ GB}$, HDD $\geq 1 \text{ TB}$, 2 x LCD Color Monitors 19 inch, USB, Gbit Ethernet</i>
<i>Numri i prerjeve te rindertuara per nje rrotullim</i>	≥ 128
<i>Shpejtesia e rindertimit te imazheve me matrice 512 x 512</i>	$\geq 50 \text{ imazhe / sec}$
<i>Kapaciteti i ruajtjes se imazheve te pakompresuara me matrice 512 x 512</i>	$\geq 400.000 \text{ imazhe}$
<i>Media Arkive ne formatin DICOM</i>	<i>CD / DVD</i>

<i>Protokollet DICOM: Print, Storage, Query/Retrieve, Modality Ëorklist, Modality Performed Procedure Step, Structured dose report</i>	<i>Te perfshihen ne oferte</i>
<i>Programet kryesore te Konsolit</i>	
<i>Teknike per optimizim te vleres se mA dhe rregullim te dozës sipas anatomisë se pacientit me ane te modulimit te rrymes ne tubin me rreze-x</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Teknike per uljen e dozës ne femije</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Teknike per studime angiografike te CT me detektim te bolusit automatik</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Teknike per reduktim te artefakteve te shkaktuara nga prania e metaleve ne trupin e pacientit</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Teknike per reduktim te zhurmave</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Rindertim shumeplanesh ne kohe reale</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Rindertim 3D</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Stacion pune (ëorkstation) i pavarur per perpunimi te metejshem "post processing"</i>	
<i>Arkitekture klient-server per minimumi 3 kliente (hardëare dhe softëare)</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Baze e pavarur per te dhenat dhe imazhet e pacienteve me perpunim kompjuterik dhe mundesi per tu perdorur ne cdo moment nga klientet</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Program i avancuar perpunimi per imazhet dixhitale volumetrike</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Program per konturim automatik / gjysemautomatik te strukturave 3D</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Te mundesoje procesimin e imazheve nga pajisje te tjera imazherike si MRI, PET, CT, etj.</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Ruajtje te imazheve dixhitale ne CD/DVD</i>	<i>Te perfshihet ne oferte</i>
<i>Nderlidhje / komunikim</i>	<i>DICOM 3.0</i>
<i>Program angiografik per matje vaskulare me heqje automatike te kockave</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Program I specializuar per indentifikimin e patologjive komplekse te mushkerive, perfshire vizualizimin automatik dhe analizimin e nodulave pulmonare dhe konfirmimin e prezences ose mungeses se lezioneve te dyshimta</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>

<p><i>Program I specializuar per:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - vleresimin sasior te patologjive pulmonare, - segmentimin automatik te mushkerive, - gjurmim volumetrik te rrugeve te frymemarjes, - identifikim i perfuzionit lidhur me Embolizmen Pulmonare, Obstuksione Kronike Pulmonare, Emfizeme Pulmonare, etj. 	<p><i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i></p>
<p><i>Program per detektimin e lezioneve te melcise, dhe auto-segmentimin e tyre, analizim te ngarkeses tumorale dhe raportim klinik automatik.</i></p>	<p><i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i></p>
<p><i>Program per ekzaminimin e perfuzionit CT neurologjik, per evidentimin e qarte te ishemive, tumoreve etj.</i></p>	<p><i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i></p>
<p><i>Endoskopi virtuale me vizualizim te lumenit te brendshem</i></p>	<p><i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i></p>
<p><i>Program per kolonografi per njohjen, shenimin dhe analizimin polipeve ne zorren e trashe me paraqitje te dyfishte te ndarjeve, skanim “prone” dhe “supine”, me kend 360 grade</i></p>	<p><i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i></p>
<p><i>Program onkologjik per ndjekje ne kohe dhe analizim krahasues te imazheve te marra nga CT, MR, PET/CT dhe X-Ray 3 dimensional</i></p>	<p><i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i></p>
<p><i>Program skanimi dentar</i></p>	<p><i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i></p>
<p><i>Permiresim i Dozes</i></p>	
<p><i>Te kete teknika te modulimit te dozes</i></p>	<p><i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i></p>
<p><i>Te kete algoritem/softëare rindertimi per reduktimin e dozes ne nivel te dhenash te paperpunuara</i></p>	<p><i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i></p>
<p><i>Te kete protokoll pediatrik me doze te ulet</i></p>	<p><i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i></p>
<p><i>Injektor kontrasti me nje koke</i></p>	
<p><i>Injektor kontrasti me presion te larte per CT</i></p>	
<p><i>Me komandim ne distance dhe ne injektor</i></p>	
<p><i>Me nje koke, me shiringe kontrasti me kapacitet:</i></p>	<p>200 mL</p>
<p><i>Fluksi</i></p>	<p>0.1- 10 ml/sec</p>
<p><i>Hapi</i></p>	<p>≤ 0.1 mL /sec</p>
<p><i>Lidhje ne Rrjet</i></p>	
<p><i>Nderfaqje e plote per imazhet, dergo, merr, printo</i></p>	<p>DICOM i plote</p>
<p><i>Aksesore te skanerit</i></p>	
<p><i>Set fantomesh per kontrollin e cilesise</i></p>	<p><i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i></p>
<p><i>Set aksesoresh per pozicionimin e pacientit</i></p>	<p><i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i></p>

Zgjatues shtrati	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
UPS	
<i>UPS per konsolen me autonomi ≥ 10min</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>UPS per stacionin e punes me autonomi ≥ 10min</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
Certifikime te Skanerit	
<i>CE (MDD 93/42 EEC)</i>	
<i>FDA</i>	
Trajnime	
<i>Furnitori duhet te ofroje dhe te perfshije ne cmim:</i>	
<i>Trajnim aplikativ per stafin operues nga nje ekspert i firmes prodhuese</i>	<i>5 dite</i>
<i>Trajnim mirembajtje per stafin teknik</i>	<i>5 dite</i>
Garancia	<i>2 vite nga ekzaminimi i pacientit te pare</i>

**SPECIFIKIME TEKNIKE
SCANNER CT 16 SLICES**

Detektorit	
<i>Fusha e pamjes se skanimit, cm</i>	≥ 50 cm
<i>Gjeresia e Detektorit (aksi-z), mm</i>	≥ 20 mm
<i>Diapazon i gjeresise se prerjes, mm</i>	<i>nga ≤ 0.7 deri ≥ 5 mm</i>
<i>Minimumi i trashesise se prerjes, mm</i>	≤ 0.625 mm
<i>Koha minimale e nje rrotullimi 360°, sekonda</i>	≤ 0.5 sec
<i>Koha maksimale e nje rrotullimi 360°, sekonda</i>	≥ 4 sec
<i>Numri i opsioneve per zgjedhjen e kohes per nje rrotullim 360°</i>	≥ 8
<i>Numri i prerjeve</i>	≥ 16
<i>Numri i rreshtave te detektorit</i>	≥ 24
Gantry	
<i>Pjerresimi (real, jo digital), grade</i>	$\pm 30^0$
<i>Diametri i dritares</i>	<i>jo me pak se 70 cm</i>
<i>Sistemi i pozicionimit</i>	<i>Lazer</i>
<i>Monitor i integruar ne gantry per paraqitjen e te dhenave te pacientit dhe kontroll te pozicionimit me ane te prekjes ne monitor</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
Tubi i Rrezeve X	
<i>Kapaciteti ngrohes i Anodes (vlera nominale, pa permiresim nga softueri), MHU</i>	≥ 6 MHU
<i>Largimi i nxehtesise se Anodes (ftohja)</i>	≥ 840 kHU/min

<i>Dy pika fokale, mm</i>	<i>Te deklarohen vlerat</i>
<i>Maksimumi i mA per piken e vogel fokale</i>	$\geq 200 \text{ mA}$
<i>Koha maksimale e ekspozimit te vazhduar ne 120 kV & 200mA</i>	$\geq 80 \text{ sec}$
Gjeneratori	
<i>Fuqia, kV (vlera nominale, pa permiresim nga softueri)</i>	$\geq 50 \text{ kv}$
<i>Fuqia, kV (vlera ekuivalente, me permiresim nga softueri)</i>	$\geq 85 \text{ kv}$
<i>Diapazoni ne dispozicion, kV</i>	<i>nga ≤ 80 deri ne $\geq 140 \text{ kV}$</i>
<i>Intensiteti I rrymes (vlera nominale, pa permiresim nga softueri), mA</i>	$\geq 400 \text{ mA}$
<i>Intensiteti I rrymes (vlera ekuivalente, me permiresim nga softueri), mA</i>	$\geq 725 \text{ mA}$
Shtrati i Pacientit	
<i>Gjatesia e shtratit, cm</i>	$\geq 220 \text{ cm}$
<i>Diapazoni i Levizjes vertikale, cm</i>	<i>nga ≤ 45 deri ne $\geq 95 \text{ cm}$</i>
<i>Levizja horizontale cm</i>	$\geq 170 \text{ cm}$
<i>Diapazoni i skanimit cm</i>	$\geq 170 \text{ cm}$
<i>Kapaciteti i peshes se shtratit, kg</i>	$\geq 220 \text{ kg}$
<i>Aksesore pozicionimi, mbajtes dhe mbeshtes per pacientin</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Pozicionues i kokës për skanim në pozicionin shtrire dhe i prirur</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
Performanca	
<i>Rezolucion Hapsinor/Rezolucion i Larte Kontrasti</i>	
<i>Rezolucioni Hapsinor Isotropik, mm</i>	$\leq 0.4 \text{ mm}$
<i>Rezolucioni Maksimal Hapsinor (MTF) ne 0%</i>	$\geq 15 \text{ lp/cm}$
<i>Rezolucioni Maksimal Hapsinor (MTF) ne 10%</i>	$\geq 12 \text{ lp/cm}$
<i>Rezolucioni Maksimal Hapsinor (MTF) ne 50%</i>	$\geq 10 \text{ lp/cm}$
<i>Detektueshmeri ne kontrastim te ulet, mm @ %</i>	$\leq 5 \text{ mm @ } 0.3 \text{ \% , ne max } 12 \text{ mGy}$
<i>Zhurma, %</i>	$\leq 0.4 \text{ \%}$
<i>Te kete algoritem rindertimi per minimimin e zhurmes</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
CT Console - Kapaciteti Rindertues	
<i>Njesia e perpunimit qendror</i>	<i>CPU 2 x Intel Xeon (ose me mire), RAM $\geq 16 \text{ GB}$, HDD $\geq 1 \text{ TB}$, 2 x LCD Color Monitors 19inch, Karte grafike profesionale $\geq 2 \text{ GB}$, USB, Ethernet</i>
<i>Fushe pamja e rindertuar, cm</i>	<i>nga ≤ 20 deri ne $\geq 50 \text{ cm}$</i>
<i>Matrica e imazheve te rindertuar</i>	512×512

<i>Koha minimale e imazheve te rindertuar me matrice 512X512 duhet te jete te pakten</i>	≥ 6 imazhe / sec
<i>Kapaciteti i ruajtjes se imazheve me matrice 512 x 512 On line</i>	≥ 200.000 imazhe
<i>Media Arkive</i>	CD / DVD
<i>Kapaciteti i rrjetit DICOM</i>	DICOM i plote
Programet kryesore te Konsolit	
<i>Program per rritje te Pitch ne skanimin spiral</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Protokoll per rastet urgjente , te mundesoje fillimin e skanimit pa vendosur te dhenat e pacientit. Vendosje automatike te te dhenave</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Teknike per reduktim te artefakteve</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Teknike per reduktim te zhurmave</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Rindertim shumeplanesh ne kohe reale</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Rindertim 3D</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Endoskopi virtuale</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
Stacion pune (ëorkstation) i pavarur per perpunimi te metejshe "post processing"	
<i>Njesi kompjuterike profesionale (workstation); hardware i perbere nga min:</i>	<i>CPU 2 x Intel Xeon Six Core 2.6GHz (ose ekuivalent), RAM ≥ 32GB, ≥ 1800 MHz, HDD ≥ 1TB, 2 x LCD Color Monitors, Karte grafike profesionale ≥ 500MB</i>
<i>Program per menaxhim te dhenash</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Program i avancuar perpunimi per imazhet dixhitale volumetrike</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Program per konturim automatik / gjysemautomatik te strukturave 3D</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Program per menaxhim seancash skanimi per disa ekzaminime te njekohshme</i>	≥ 6 seanca
<i>Te mundesoje procesimin e imazheve nga pajisje te tjera imazherike si MRI, PET, CT, etj.</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Ruajtje te imazheve dixhitale ne CD/DVD</i>	PO
<i>Nderlidhje / komunikim</i>	DICOM 3.0
<i>Program Angiografik me ndjekje automatike te vazes aortike ne abdomen dhe heqjen e kockave</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Program I specializuar per indentifikimin e patologjive komplekse te mushkerive, perfshire vizualizimin automatik dhe analizimin e nodulave pulmonare</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>

<p><i>Program I specializuar per:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - vleresimin sasior te patologjive pulmonare, - segmentimin automatik te mushkerive, - gjurmim volumetrik te rrugeve te frymemarjes, - identifikim i perfuzionit lidhur me Embolizmen Pulmonare, Obstuksione Kronike Pulmonare, Emfizeme Pulmonare, etj. 	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Program skanimi dentar</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
Permiresim i Dozes	
<i>Te kete teknika te modulimit te dozes</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Te kete algoritem/softëare rindertimi per reduktimin e dozes ne nivel te dhenash te paperpunuara</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Te kete protokoll pediatrik me doze te ulet</i>	<i>Te perfshihet ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
Kapaciteti Ekzaminues	
<i>Topograma - scout</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Modaliteti Spiral</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Pakete spirale, per perfim spiral ose vëllimor me kohë të vazhdueshme të skanimit të pandërprerë, sec</i>	$\geq 100 \text{ sec}$
<i>Mundësia e marrjes në të njëjtën kohë të paktën 16 prerje për rrotullim në modalitetin spiral</i>	$\geq 16 \text{ prerje}$
<i>Modaliteti Aksial</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Mundësi per marrjen në të njëjtën kohë të paktën 16 prerje për rrotullim ne modalitetin aksial</i>	$\geq 16 \text{ prerje}$
<i>Sistemi te jete i afte te marre imazhe ne modalitetin aksial dhe spiral duke perdorur dy energji te ndryshme x-ray per shtim te informacionit klinik</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
Injektor kontrasti me nje koke	
<i>Injektor kontrasti me presion te larte per CT</i>	
<i>Me komandim ne distance dhe ne injektor</i>	
<i>Me nje koke, me shiringe kontrasti me kapacitet:</i>	200 mL
<i>Fluksi</i>	0.1- 10 ml/sec
<i>Hapi</i>	$\leq 0.1 \text{ mL /sec}$
Lidhje ne Rrjet	
<i>Nderfaqje e plote per imazhet, dergo, merr, printo</i>	DICOM i plote
Aksesore te skanerit	

<i>Tavolina e punes dhe ndenjese per operatorin ne dhomen e operimit</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Set fantomesh per kontrollin e cilesise</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Set aksesoresh per pozicionimin e pacientit</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>Zgjatues shtrati</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
UPS	
<i>UPS per konsolen autonomi ≥ 10min</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
<i>UPS per stacionin e punes me autonomi ≥ 10min</i>	<i>Te perfshihen ne oferte, pershkrim i detajuar</i>
Certifikime te Skanerit	
<i>CE (MDD 93/42 EEC)</i>	
<i>FDA</i>	
Trajnime	
<i>Furnitori duhet te ofroje dhe te perfshije ne cmim:</i>	
<i>Trajnim aplikativ per stafin operues nga nje ekspert i firmes prodhuese</i>	<i>5 dite</i>
<i>Trajnim mirembajtje per stafin teknik</i>	<i>5 dite</i>
Garancia	<i>2 vite nga ekzaminimi i pacientit te pare</i>

III.1.5. Në shtojcën 1 të publikuar nga autoriteti kontraktor “Modifikim në DST të procedurës së prokurimit me objekt “F.V Pajisje mjekësore –CT Scanner””, për modifikimin e dokumenteve të tenderit përcaktohet:

II. Në Shtojcën 10 të DST “Specifikimet Teknike” për artikullin “Scanner Ct 64 Slices”:

Ishte:

Numri total i elementeve të detektorit $\geq 54,000$

Bëhet:

Numri total i elementeve të detektorit $\geq 47,000$

Ishte:

Shkalla e absorbimit nga detektorit $\geq 98\%$

I pajisur me sistem të avancuar marrje të dhënash për përmirësim maksimal të performancës së imazhit, reduktim maksimal zhurmash dhe frekuence maksimale të kampionimit jo më pak se: $\geq 2400\text{Hz}$

Bëhet:

Hiqet specifikimi: Shkalla e absorbimit nga detektorit $\geq 98\%$

I pajisur me sistem të avancuar marrje të dhënash për përmirësim maksimal të performancës së imazhit, reduktim maksimal zhurmash dhe frekuencë maksimale të kampionimit jo më pak se: $\geq 2400\text{Hz}$

Ishte:

Kapaciteti ngrohës i Anodes (vlera ekuivalente, me përmirësim nga softueri), $\text{MHU} \geq 35 \text{MHU}$

Bëhet:

Kapaciteti ngrohës i Anodes (vlera ekuivalente, me përmirësim nga softueri), $\text{MHU} \geq 30 \text{MHU}$

Ishte:

Fokusi i vogël $\leq 0.65 \text{ mm}^2$

Fokusi i madh $\leq 1.32 \text{ mm}^2$

Bëhet:

Fokusi i vogël: Të deklarohet vlera

Fokusi i madh : Të deklarohet vlera

Ishte:

Fuqia, kV (vlera ekuivalente, me përmirësim nga softueri) $\geq 250 \text{ kV}$,

Bëhet:

Fuqia, kV (vlera ekuivalente, me përmirësim nga softueri) $\geq 120 \text{ kV}$,

Ishte:

Diapazoni në dispozicion, kV nga ≤ 80 deri në $\geq 140 \text{ kV}$

Bëhet:

Diapazoni në dispozicion, kV nga ≤ 80 deri në $\geq 135 \text{ kV}$

Ishte:

Kapaciteti i peshës së shtratit, kg $\geq 225 \text{ kg}$

Bëhet:

Kapaciteti i peshës së shtratit, kg $\geq 220 \text{ kg}$

Ishte:

Rezolucioni hapësinor, në shpejtësinë maksimale të rrotullimit (FOV=50cm), $\leq 0.28 \text{ mm}$

Bëhet:

Rezolucioni hapësinor, në shpejtësinë maksimale të rrotullimit (FOV=50cm), $\leq 0.30 \text{ mm}$

Ishte:

Diapazoni i Lëvizjes vertikale, cm nga ≤ 50 deri në $\geq 80 \text{ cm}$

Bëhet:

Diapazoni i Lëvizjes vertikale, cm nga ≤ 55 deri në $\geq 80 \text{ cm}$

Ishte:

Njësia e përpunimit qendror Shpejtësia e rindërtimit të imazheve me matricë $512 \times 512 \geq 50$ imazhe / sec, CPU 2 x Intel Xeon (ose ekuivalent), RAM $\geq 32\text{GB}$, HDD $\geq 1\text{TB}$, 2 x LCD Color Monitors 19 inch, USB, Gbit Ethernet

Bëhet:

Njësia e përpunimit qendror Shpejtësia e rindërtimit të imazheve me matricë $512 \times 512 \geq 40$ imazhe / sec, CPU 2 x Intel Xeon (ose ekuivalent), RAM $\geq 32\text{GB}$, HDD $\geq 1\text{TB}$, 1ose 2 x LCD Color Monitors 19 inch, USB, Gbit Ethernet

Ishte:

Certifikime të Skanerit: FDA

Certifikime të Skanerit: CE

Bëhet:

Certifikime të Skanerit: CE ose FDA

Ishte:

Trajnim aplikativ për stafin operues nga një ekspert i firmës prodhuese

Bëhet:

Trajnim aplikativ për stafin operues nga një inxhinier i certifikuar (nga firma prodhuese) i operatorit ekonomik

III. Në Shtojcën 10 të DST “Specifikimet Teknike” për artikullin “Scanner Ct 16 Slices”:

Ishte:

Diapazon i gjerësisë së prerjes, mm nga ≤ 0.7 deri ≥ 5 mm,

Minimumi i trashësisë së prerjes, mm ≤ 0.625 mm,

Bëhet:

Diapazon i gjerësisë/trashësisë së prerjes, mm nga ≤ 0.65 deri ≥ 5 mm

Hiqet Specifikimi: Minimumi i trashësisë së prerjes, mm ≤ 0.625 mm

Ishte:

Intensiteti i rrymës (vlera ekuivalente, me përmirësim nga softueri), mA ≥ 725 mA

Bëhet:

Hiqet specifikimi: Intensiteti i rrymës (vlera ekuivalente, me përmirësim nga softueri), mA ≥ 725 mA

Ishte:

Diapazoni i Lëvizjes vertikale, cm nga ≤ 45 deri në ≥ 95 cm

Bëhet:

Diapazoni i Lëvizjes vertikale, cm nga ≤ 45 deri në ≥ 90 cm

Ishte:

Koha maksimale e një rrotullimi 360°, sekonda ≥ 4 sec

Bëhet:

Koha maksimale e një rrotullimi 360°, sekonda ≥ 2 sec

Ishte:

Monitor i integruar në gantry për paraqitjen e të dhënave të pacientit dhe kontroll të pozicionimit me anë të prekjes në monitor kërkohet Të përfshihen në oferte, përshkrim i detajuar

Bëhet:

Monitor i integruar në gantry për paraqitjen e të dhënave të pacientit dhe kontroll të pozicionimit me prekje ose butona kërkohet Të përfshihet në ofertë, përshkrim i detajuar

Ishte:

Numri i opsioneve për zgjedhjen e kohës për një rrotullim 360°: ≥ 8

Bëhet:

Numri i opsioneve për zgjedhjen e kohës për një rrotullim 360°: ≥ 6

Ishte:

Kapaciteti ngrohës i Anodes (vlera nominale, pa përmirësim nga softueri), MHU: ≥ 6 MHU,

Bëhet:

Kapaciteti ngrohës i Anodes (vlera nominale, pa përmirësim nga softueri), MHU: ≥ 5 MHU,

Ishte:

Largimi i nxehtësisë së Anodes (ftohja) ≥ 840 kHU/min

Bëhet:

Largimi i nxehtësisë së Anodes (ftohja) ≥ 800 kHU/min

Ishte:

Fuqia, kV (vlera ekuivalente, me përmirësim nga softueri) ≥ 85 kV

Bëhet:

Fuqia, kV (vlera ekuivalente, me përmirësim nga softueri) ≥ 80 kV

Ishte:

Diapazoni në dispozicion, kV nga ≤ 80 deri në ≥ 140 kV,

Bëhet:

Diapazoni në dispozicion, kV nga ≤ 90 deri në ≥ 135 kV

Ishte:

Gjatësia e shtratit, ≥ 220 cm

Bëhet:

Hiqet Specifikimi: Gjatësia e shtratit, ≥ 220 cm

Ishte:

Diapazoni i Lëvizjes vertikale, cm nga ≤ 45 deri në ≥ 95 cm

Bëhet:

Diapazoni i Lëvizjes vertikale, cm nga ≤ 45 deri në ≥ 90 cm

Ishte:

Zhurma, % ≤ 0.4 %,

Bëhet:

Hiqet Specifikimi: Zhurma, % ≤ 0.4 %,

Ishte:

Njësia e përpunimit qendror CPU 2 x Intel Xeon (ose më mirë), RAM ≥ 16 GB, HDD ≥ 1 TB, 2 x LCD Color Monitors 19inch, Kartë grafike profesionale ≥ 2 GB, USB, Ethernet

Bëhet:

Njësia e përpunimit qendror CPU 2 x Intel Xeon (ose ekuivalent), RAM ≥ 16 GB, HDD ≥ 1 TB, 1 ose 2 x LCD Color Monitors 19inch, Kartë grafike profesionale ≥ 2 GB, USB, Ethernet

Ishte:

Sistemi të jetë i aftë të marrë imazhe në modalitetin aksial dhe spiral duke përdorur dy energji të ndryshme x-ray për shtim të informacionit klinik,

Bëhet:

Hiqet Specifikim: Sistemi të jetë i aftë të marrë imazhe në modalitetin aksial dhe spiral duke përdorur dy energji të ndryshme x-ray për shtim të informacionit klinik

Ishte:

Certifikime të Skanerit: FDA

Certifikime të Skanerit: CE

Bëhet:

Certifikime të Skanerit: CE ose FDA

III.1.6. Gjithashtu në shtojcën 2 të publikuar nga autoriteti kontraktor “Modifikim (2) në DST të procedurës së prokurimit me objekt “F.V Pajisje mjekësore –CT Scanner””, për modifikimin e dokumenteve të tenderit përcaktohet:

I. Në Shtojcën 10 të DST “Specifikimet Teknike” për artikullin “Scanner Ct 64 Slices”:

Ishte:

Kapaciteti ngrohës i Anodës (vlera nominale, pa përmirësim nga softueri), MHU ≥ 7 MHU Bëhet:

Kapaciteti ngrohës i Anodës (vlera nominale, pa përmirësim nga softueri), MHU ≥ 5 MHU

Ishte:

Largimi i nxehtësisë së Anodës (ftohja) ≥ 1000 kHU

Bëhet:

Largimi i nxehtësisë së Anodës (ftohja) ≥ 840 kHU

Ishte:

Rezolucioni Maksimal i Kontrastit (MTF) në 4% ≥ 18 lp/cm

Bëhet:

Rezolucioni Maksimal i Kontrastit (MTF) në 2% ≥ 21 lp/cm ose në 4% ≥ 18 lp/cm.

Ishte:

Pajisur me ekran për parametrat e skanimit dhe EKG

Bëhet:

Pajisur me ekran për parametrat e skanimit

Sqarim:

Në lidhje me specifikimin: Diapazoni në dispozicion, kV nga ≤ 80 deri në ≥ 135 kV sqarojmë se minimumi i detyrueshëm i diapazonit të lëvizjes së tensionit është ≤ 80 deri në ≥ 135 kV. Të gjitha vlerat e ofruara nga OE të cilat e përfshijnë këtë diapazon do konsiderohen të rregullta.

III. Në Shtojcën 10 të DST “Specifikimet Teknike” për artikullin “Scanner Ct 16 Slices”:

Hiqet Specifikimi:

“Program për menaxhim seancash skanimit për disa ekzaminime të njëkohshme ≥ 6 seanca”

Hiqet Specifikimi:

“Rezolucioni Maksimal Hapësinor (MTF) në 0% ≥ 15 lp/cm”

Hiqet Specifikimi:

“Rezolucioni Maksimal Hapësinor (MTF) në 10% ≥ 12 lp/cm”

Hiqet Specifikimi:

“Rezolucioni Maksimal Hapësinor (MTF) në 50% ≥ 10 lp/cm”

Sqarim:

Në lidhje me specifikimin: Diapazoni në dispozicion, kV nga ≤ 90 deri në ≥ 135 kV, sqarojmë se minimumi i detyrueshëm i diapazonit të lëvizjes së tensionit është ≤ 90 deri në ≥ 135 kV. Të gjitha vlerat e ofruara nga OE të cilat e përfshijnë këtë diapazon do konsiderohen të rregullta.

III.1.7. Gjithashtu në shtojcën 3 të publikuar nga autoriteti kontraktor “Modifikim në DST të procedurës së prokurimit me objekt “F.V Pajisje mjekësore –CT Scanner”, për modifikimin e dokumenteve të tenderit përcaktohet:

II. Në Shtojcën 10 të DST “Specifikimet Teknike” për artikullin “Scanner CT 16 slices CT 64 slices”:

CT 16 slices:

Ishte:

Njësia e përpunimit qendror CPU 2 x Intel Xeon (ose më mirë), RAM ≥ 16 GB, HDD ≥ 1 TB, 2 x LCD Color Monitors 19inch, Kartë grafike profesionale ≥ 2 GB, USB, Ethernet.

Bëhet:

Njësia e përpunimit qendror CPU 2 x Intel Xeon (ose ekuivalent), RAM ≥ 16 GB, HDD ≥ 800 GB, 1 ose 2 x LCD Color Monitors 19inch, Kartë grafike profesionale ≥ 2 GB, USB, Ethernet.

CT 64 slices:

Ishte: Njësia e përpunimit qendror Shpejtësia e rindërtimit të imazheve me matricë 512 x 512 ≥ 50 imazhe / sec, CPU 2 x Intel Xeon (ose ekuivalent), RAM ≥ 32 GB, HDD ≥ 1 TB, 2 x LCD Color Monitors 19 inch, USB, Gbit Ethernet.

Bëhet:

Njësia e përpunimit qëndror Shpejtësia e rindërtimit të imazheve me matricë 512 x 512 ≥ 40 imazhe / sec, CPU 2 x Intel Xeon (ose ekuivalent), RAM ≥ 32GB, HDD ≥ 800GB, Iose 2 x LCD Color Monitors 19 inch, USB, Gbit Ethernet.

Sqarim: Ne vijim te Vendimit te KPP , nr.349/2020, date 28.08.2020, pikes III.1.6.21, MSHMS sqaron sa me poshte: MSHMS ne rolin e AK siguron OE se do te ndermarre te gjitha masat per te mos shkaktuar asnje vonese ne instalimin e pajisjeve mjekesore, duke mos shkatuar djegien e fondeve.

III.1.8. Në nenin 46, pika 1/a e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.1.9. Në nenin 27, pika 3 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi.

III.1.11. Nisur nga arsyet e skualifikimit të operatorëve ekonomikë ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. KPP thekson se, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (parashikuar nga neni 2 gërma “b” dhe “c” e LPP-së), janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Specifikimet teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit

qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 23 të LPP-së, KPP gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar tre metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me referimin e standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. Metoda e dytë e hartimit të specifikimeve teknike lidhet me referimin e kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale. Gjithashtu, edhe metoda e tretë, e cila është një ndërthurje e dy metodave të mësipërme, por çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Autoritet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë me përpikëri dispozitën e mësipërme të LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

III.1.12. Konkretisht, në këtë rast, referuar pretendimeve të ankimesve, raportit të hartuar nga eksperti i pavaruar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton ndër të tjera, referuar aktit të ekspertimit, eksperti ka deklaruar se: “*Eksperti nuk ka kryer vlerësimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të vendosura nga AK me kërkesa, udhëzues standarde apo kritere, të hartuara dhe miratuara, mbi të cilat AK ka hartuar specifikimet teknike, pasi AK nuk i ka referuar këto akte, mbi të cilat janë bazuar për pajisjet CT 16 dhe CT 64 në DST (si përshkrimi, funksionaliteti, vlerat e propozuara etj.).*” Referuar sa më sipër, KPP konstaton se referuar akt ekspertimit është deklaruar ndër të tjera se autoriteti kontraktor nuk ka referuar në terma funksionaliteti të pajisjes së kërkuar.

III.1.13. Referuar Raportit të Vlerësimit të dorëzuar nga eksperti në datë 15.04.2021, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ky i fundit referuar pyetjeve të drejtuara nga KPP sipas procesverbalit të mbajtur në seancën dëgjimore midis palëve në datë 31.03.2021, në lidhje me

dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK. ndër të tjera është shprehur:

“[...] OE ka ofruar CT skaner “Somatom go.Top”, 128 slice për kërkesën CT64. Somatom go.Top është e gjeneratës së fundit të skanerëve helikoidalë që mundëson një gamë të madhe ekzaminimesh më cilësi të lartë imazhesh duke përfshirë ekzaminimet me energji të dyfishtë dhe mundësitë për përdorimin e inteligjencës artificiale. Kërkesat minimale të një pajisje skaner me 64 shtresa, kjo pajisje i plotëson (ËHO). Ka edhe specifikime të tjera (shih më lart) të cilat nuk ofrohen në nivelin e kërkuar nga AK dhe ato plotësohen pjesërisht. [...]

[...]Përgjigje për CT 16: Sikundër është cituar në fillim të vlerësimit, pajisja e propozuar është vlerësuar përkundrejt specifikimeve teknike të kërkuara nga AK. Në vlerësimin e përgjithshëm ato nuk përmbushen. Referuar kriteret minimale që duhet të plotësojë një pajisje CT skaner 16 slice, ato plotësohen nga CT 64, e ofruar nga operatori ekonomik.

Përgjigje për CT 64: Edhe për pajisjen e propozuar CT 128 për pajisjen CT skaner 64 slice, në vlerësimin e përgjithshëm përkundrejt kërkesave të AK, ato përmbushen pjesërisht. Referuar kriterëve minimale që duhet të plotësojë një pajisje CT skaner 64 slice, ato plotësohen nga CT 128, e ofruar nga operatori ekonomik.

Gjithashtu, referuar Raportit të Vlerësimit të dorëzuar nga eksperti në datë 15.04.2021, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ky i fundit referuar pyetjeve të drejtuara nga KPP sipas procesverbalit të mbajtur në seancën dëgjimore midis palëve në datë 31.03.2021, në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK. ndër të tjera është shprehur:

[...] CT skaneri “Acquillon Prime SP” multislice me 80 rreshta detektorësh me kapacitet gjenerimi 160 slice për një rrotullim, i përket gjeneratës së fundit të skanerëve helikoidalë duke mundësuar shumë ekzaminime skanografike, imazhe me cilësi të lartë, përpunimesh dhe vizualizimesh anatomike etj. Sikundër është cituar në fillim të vlerësimit, pajisja e propozuar është vlerësuar përkundrejt specifikimeve teknike të kërkuara nga AK. Pavarësisht se në vlerësimin e përgjithshëm kërkesat e mësipërme përmbushen pjesërisht, referuar kriterëve minimale që duhet të plotësojë një pajisje CT skaner 64 slice, ato përmbushen nga pajisja e ofruar për qëllimin dhe funksionalitetin e pajisjes së kërkuar.

III.1.14. KPP gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 1 pika 2 gërma “dh” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces. Kështu, Komisioni i Prokurimit Publik në drejtim të pyetjeve drejtuar ekspertit, për të cilën palët pjesëmarrëse në seancën dëgjimore nuk kanë patur pretendime, ndërkohë që autoriteti kontraktor shfaqet në mungesë, janë drejtuar si në kuadër të verifikimit formal nëse specifikimet teknike të kërkuar përmbushen nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, gjithashtu edhe nëse padisja në tërësi përmbush qëllimin e kërkit të autoritetit kontraktor si edhe veçanërisht në drejtim të funksionalitetit të saj. Në tërësi të përgjigjeve të ekspertit konstatohet se pajisjet e propozuara janë të një gjenerate më të re se ajo e kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe ato përmbushen nga pajisja e ofruar për qëllimin dhe funksionalitetin e pajisjes së kërkuar.

Në kushte të tilla KPP gjykon se specifikimet teknike të mësipërme për të cilat operatorët ekonomikë nuk kanë parashtruar pretendime pranë Komisionit të Prokurimit Publik në periudhën kur janë paraqitur pretendime në lidhje me dokumentet e tenderit, kanë shkaktuar kufizim të konkurrencës dhe nuk janë hartuar në përputhje me legjislacioni në fuqi, frymën e tij si edhe standardeve ndërkombëtare të përmendur në raportin e ekspertimit të ekspertit të pavarur.

Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik nënvizon se në kushtet aktuale, në publikimin e procedurës së re të prokurimit, autoriteti kontraktor do të zbatojë ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” si ligj i zbatueshëm. Referuar frymës së legjislacionit të ri për prokurimin publik, ligjvënësi ka parashikuar edhe metoda të tjera të hartimit të specifikimeve teknike ashtu edhe të përmbushjes së tyre nga ana e operatorëve ekonomikë.

III.1.15. Sa më sipër, nisur nga specifika e objektit të prokurimit, nga shqyrtimi në tërësi i specifikimeve teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor, si dhe referuar argumentimeve dhe ekspertizës së posaçme të dhënë nga eksperti i pavarur, KPP gjykon se autoriteti kontraktor në lidhje me specifikimet teknike ka përdorur kërkesa të ekzagjeruara, të cilat diskriminojnë operatorët ekonomikë si dhe kufizojnë konkurrencën dhe pjesëmarrjen e një numri të gjerë operatorësh ekonomikë, të cilët janë të gatshëm të ofrojnë produkte të cilat përmbushin më së miri qëllimin dhe funksionalitetin e pajisjeve që kërkon autoriteti kontraktor.

III.1.16. Sa më sipër, në kushtet kur konstatohet se disa nga specifikimet teknike në procedurën e mësipërme të prokurimit janë hartuar në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi, si dhe standardet ndërkombëtare duke ndikuar kështu në vlerësimin dhe klasifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, një situatë e tillë përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimi.

Kriteret e kualifikimit duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të mirëpërcaktuara nga autoriteti kontraktor me qëllim që të jenë sa më të kuptueshme jo vetëm për operatorët ekonomikë të interesuar për të qenë pjesëmarrës, komisionin e vlerësimit të ofertave në mënyrë të tillë që procesi i vlerësimit të mos kryhet me subjektivizëm, por të vendosë në situatë të barabartë edhe për personat me aftësi të kufizuar, duke mos penguar kështu pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi. Kriteret për kualifikim vendosen në mënyrë që autoriteti kontraktues të krijojë një panoramë të qartë mbi kapacitetet ekonomiko – financiare, tekniko – profesionale dhe eksperiencën e operatorëve ekonomikë që janë pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik, bazuar në nenin 64, pika 3 të LPP – së, gjykon se situata konfuze e krijuar nga mospërcaktimi i saktë i kriterëve për kualifikim, konkretisht i specifikimeve teknike, përbën shkak për anulimin e kësaj procedure prokurimi.

Në nenin 31 pika 2 gërma “d” të Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” parashikohet se: “[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: d) Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin kontraktues për rifillimin e procedurës së prokurimit [...]”.

Në kushtet kur autoriteti kontraktor ka vlerësuar mbi kriteret të pasakta dhe evasive, mbi të cilat ka bërë edhe vlerësimin dhe kualifikimin/skualifikimin e operatorëve ekonomikë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimet e operatorit ekonomik ankimes nuk do të merren në shqyrtim pasi procedura e prokurimit duhet të anulohet.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-65892-07-18-2020, me objekt “F.V Pajisje mjekësore – CT Scanner”, me fond limit 144.112.500 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 23.09.2020, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
 2. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK. në procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK dhe operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1397 Protokolli
Datë 02.11.2020

Nr. 1401 Protokolli
Datë 02.11.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri